

RAPORT I PUNËS 2019

KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR

НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ

NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

K. Petroviq 237., 17520 Bujanoc, R. SerbiTel/fax: 00381 17 653 264, e-mail: kksh.bujanoc@gmail.com
kksh.lugina@outlook.com



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR

RAPORT I PUNËS 2019

Bujanoc, 2019

KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR

Këshilli Kombëtar Shqiptar është organ përfaqësues i pakicës nacionale shqiptare në Republikën e Serbisë, përmes të cilit pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare ushtrojnë të drejtat e tyre në vetëqeverisjen e pakicës në fushat e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtarë të gjuhës dhe të shkrimit shqip (Statuti i Këshilli Kombëtar Shqiptar, 2/2010, 118/2012, 553-3/19).

Autor:

Ragmi Mustafa – kryetar & Ekipi i KKSH

Copyright

© Këshilli Kombëtar Shqiptar (KKSH), Nëntor 2019. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritës ose të transmetohet në çfarëdolloj forme ose mjete, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi, ose ndonjë formë tjetër, pa lejen paraprake të KKSH-së.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
STRUKTURA E KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR.....	6
KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR.....	7
Kwadri institucional - Këshilli Kombëtar Shqiptar.....	7
Statusi juridik.....	8
Qëllimi dhe fushëveprimi.....	9
Objektivat.....	10
REALIZIMI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR.....	11
KULTURA.....	14
Korniza juridike dhe iniciativat e ndërmara.....	14
Kompetencat ligjore të Këshillit.....	15
ARSIMI.....	16
Korniza juridike dhe iniciativat e ndërmara.....	16
SHKOLLIMI I KOMUNITETIT SHQIPTAR.....	18
Tekstet në gjuhën shqipe.....	20
Mungesa e teksteve shkollore.....	21
Tekstet, të cilat fillimisht duhet të përgatiten në gjuhën shqipe sipas Memorandumit.....	21
Tekstet 2019.....	22
Pasqyrimi i institucioneve arsimore.....	23
Numri i nxënësve.....	24
Në shkollat filllore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe.....	24
Mosnjohja e diplomave të Kosovës.....	27
Zgjidhjet e ofruara.....	27
Problemet e identifikuara në procesin e arsimit për komunitetin shqiptar.....	28
Përfundim mbi mungesën e teksteve mësimore.....	29
INFORMIMI.....	30
Korniza juridike.....	30
INFORMIMI NË GJUHËN SHQIPE.....	31
PËRDORIMI ZYRTAR I GJUHËS DHE I SHKRIMIT.....	32
Korniza juridike.....	33
Kompetencat ligjore të Këshillit kombëtare.....	34

PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË AUTORITETET ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE.....	35
E DREJTA E SHËNIMIT TË EMRIT PERSONAL NË GJUHËN SHQIPE.....	38
SHENJAT TOPOGRAFIKE.....	41
REGJISTRIMI I VITIT 2011.....	41
PERSONAT E SHPËRNGULUR, PASIVIZIMI.....	43
PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE INSTITUCIONALE.....	44
PJESËMARRJA NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE SISTEMIN GJYQËSOR.....	44
KËRKESAT PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJEVE TË HAPURA NË LUGINËN E PRESHEVËS	45
INSTITUCIONI I KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR.....	49

Hyrje

Miratimi i Ligjit¹ në vitin 2009, për formimin e Këshillave Kombëtare të Pakicave Nacionale që jetojnë në Serbi, në Parlamentin e Republikës së Serbisë, i ka mundësuar edhe shqiptarëve që ta themelojnë këtë institucion të rëndësishëm së veçantë. Por, me vendim të Gjykatës Kushtetuese disa nga dispozitat e rëndësishme ligjore janë suspenduar e janë përligjur me aprovimin më vitin 2018.

Ligji për formimin e Këshillave Kombëtare të Pakicave Nacionale është i bazuar në Konventën e Këshillit të Evropës për të Drejtat Kolektive të Pakicave Kombëtare, në të cilën parashihen kompetencat në lëmin e arsimit, kulturës, informimit, përdorimit zyrtar të gjuhës dhe simboleve kombëtare.

Deri më tani ky institucion ka hapur proceset me rëndësi jetike për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë si dhe gjetiu në Republikën e Serbisë përmes Komisioneve përkatëse.

Gjithashtu, Këshilli Kombëtar Shqiptarë ka mandatin për zgjedhjen e gjitha çështjeve që janë me interes nacional të shqiptarëve në Serbi.

¹ Ligji për Këshillat Kombëtar të Pakicave Nacionale (“Gazeta zyrtare e RS” nr.72/2009, 20/2014 – vendimi i GJK, 55/2014)

STRUKTURA E KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Këshilli Kombëtar Shqiptar në Serbi (KKSH) është i vetmi institucion legal shtetëror në Serbi, që është në funksion të mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit të identitetit kulturorë e kombëtar. Ka mandatin për zgjedhjen e të gjitha çështjeve që janë me interes nacional të shqiptarëve në Serbi. Këshilli Kombëtar Shqiptar është i bazuar në Konventën e Këshillit të Evropës për të Drejtat Kolektive të Pakicave Kombëtare i paraparë me kompetenca në arsim, kulturë, informimit, përdorimit zyrtar të gjuhës dhe simboleve kombëtare.

Këshilli Kombëtar Shqiptar është organ përfaqësues i pakicës nacionale shqiptare në Republikën e Serbisë, përmes të cilit pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare ushtrojnë të drejtat e tyre në vetëqeverisjen e pakicës në fushat e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtarë të gjuhës dhe të shkrimit shqip².

Struktura

- Këshilli Kombëtar Shqiptar,
- Kryetari, zv/kryetar,
- Sekretari/e,
- Organi Ekzekutiv,
- Komisioni për arsim,
- Komisioni për kulturë,
- Komisioni për informim dhe botime,
- Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip,
- Shërbimi profesional,

Kompetencat e përcaktuara me Ligjin mbi këshillat kombëtare të pakicave nacionale (“Gazeta zyrtare e RS” nr.72/2009, 20/2014 – vendimi i GJK, 55/2014) dhe programi i punës së Këshilli Kombëtar të Pakicës Nacionale Shqiptare, janë realizuar me angazhimin e të gjithë anëtarëve të Këshilli Kombëtar të Pakicës Nacionale Shqiptare, anëtarëve të organit ekzekutiv, Komisioneve përkatëse dhe trupave punuese në kuadër të KKSH, nën komisioneve dhe personave të tjerë të angazhuar për kryerjen e detyrave të caktuara, në bashkëpunim me faktorë të rëndësishëm vendor dhe ndërkombëtar.

² Statuti i Këshillit Kombëtar i pakicës nacionale shqiptare nenit 2 (“Gazeta zyrtare e RS” nr.72/2009, 20/2014 – vendimi i GJK, 55/2014)

KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR

Kuadri institucional - Këshilli Kombëtar Shqiptar

Kuadri institucional dhe statusi ligjor i pakicave nacionale është e rregulluar me dokumente të ndryshme ligjore që garantojnë të drejtat e pakicave në Serbi. Kuadri ligjor është vendosur nga Kushtetuta e Republikës së Serbisë, traktatet ndërkombëtare, aktet ligjore dhe nënligjore.

Në gusht të vitit 2009. Parlamenti serb miratoi Ligjin për këshillat kombëtar të pakicave kombëtare dhe rregullimin në detaje pozicionin dhe përgjegjësitë e këtyre organeve. Ligji për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale në vitin 2002. Ligji për Këshillat e pakicave kombëtare ka ngritur bazën ligjore për mbrojtjen e pakicave në Serbi. Gjithashtu në vitin 2018 është bërë ndryshimi dhe plotësimi i këtyre dy ligjeve përkatëse, me çrast propozimet e KKSH janë neglizhuar dhe ka konsideruar se nuk plotëson nevojat e komunitetit shqiptar dhe nuk i përgjigjet sfidave që ka përballë me këtë infrastruktur ligjore.

Ligjin për këshillat kombëtar të pakicave kombëtare që rregullojnë autoritetin e këshillave kombëtar të pakicave kombëtare në jetën kulturore, arsimit, informimit dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, si dhe procedurën e zgjedhjes së këshillave kombëtare, financimin e tyre dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e KKSH.

KKSH përfaqëson komunitetin shqiptar në fushat e arsimit, kulturës, informimit dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, merr pjesë në vendim-marrje ose vendosë mbi çështjet nga këto fusha, krijon institucione, shoqata dhe organizata të tjera nga këto fusha.

Hapi i parë në punën e KKSH ishte përcaktimi i drejtimeve strategjike dhe masat për të siguruar realizimin e të drejtave të shqiptarëve të garantuara me ligj.

Si objektiva specifike, ishin dhe më tej mbeten, të sigurohet përdorimi i teksteve mësimore për nxënësit e shkollimit fillor e të mesëm, tekstet e botuara në Tiranë duke qëndruar i hapur edhe për alternativat tll tjera që ofron ligji; Që mbrojtjen e gjuhës, shkrimit, kulturës, traditës, historisë dhe informimit shqip në Luginë të Preshevës duke ruajtur gjithsesi edhe vlerat e luftës së lavdishme të UÇPMB-së; dhe gardian i vendimeve të përbashkëta të dala nga Kuvendi i Këshilltarëve Shqiptar të Luginës së Preshevës si organi më i lartë jo formal. Në këtë drejtim janë orientuar të gjitha aktivitetet dhe burimet e nevojshme për të përmirësuar situatën aktuale në fushat e kompetencave juridike të Këshillit.

Statusi juridik

Kthesën për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare në Serbi (atëherë në kuadër të RS të Jugosllavisë) e ka krijuar Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare (viti 2002, në tekstin e mëtejme: Ligji për pakicat kombëtare), i cili e ka vendosur bazën juridike për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe të identitetit të tyre kulturor përmes instrumenteve të ndryshme dhe mekanizmat në fushën e arsimit, gjuhës, informimit dhe kulturës. Ligji i ka pranuar jo vetëm të drejtat individuale të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, por edhe të drejtat kolektive të pakicave kombëtare, si grup. Në pajtim me këtë ligj është aprovuar e drejta për autonomi kulturore e pakicave kombëtare dhe institucioni i Këshillit të pakicave kombëtare. Në ligj dukshëm ka ndikuar Konventa orientuese për mbrojtjen e pakicave kombëtare (e aprovuar në vitin 1995 në kuadër të Këshillit të Evropës, Serbia e ka aprovuar në vitin 2001) e cila gjithashtu e përbën pjesën e rendit nacional juridik të Serbisë. Karta Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave (Këshilli i Evropës në vitin 1992, Serbia ka ratifikuar në vitin 2005) gjithashtu është dokument vendimtar ndërkombëtar lidhur me gjuhët e pakicave i cili ndikon në mbrojtjen e pakicës kombëtare në Serbi. Standardet nga Ligji për pakicat kombëtare janë pranuar në Kushtetutën e Republikës së Serbisë nga viti 2006, kështu që tërë Kaptina 3, në pjesën e dytë të Kushtetutës u kushtohet të drejtave të pakicave. Gjithashtu Kushtetuta e njej të drejtën për autonomi kulturore dhe të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare të zgjedhin këshillat e veta kombëtare të pakicave. Në Kushtetutën e Republikës së Serbisë këshillat kombëtare të pakicave e kanë fituar statusin kushtetues.

Në gusht të vitit 2009, Kuvendi i Republikës së Serbisë e ka aprovuar Ligjin për këshillat e pakicave kombëtare dhe hollësisht e ka rregulluar pozitën dhe kompetencat e këtyre organeve. Ligji për pakicat kombëtare dhe ligji për këshillat e pakicave kombëtare e kanë vendosur bazën juridike për mbrojtjen e pakicave në Serbi. Për aplikimin e të drejtave të pakicave me rëndësi të madhe janë edhe ligjet tjera, me të cilat rregullohen çështjet e ndryshme (arsimi, kultura, letërnjoftimet, informimi, përdorimet zyrtare të gjuhëve dhe të alfabetëve, etj.), të cilat merren me çështjen e pakicave. Meqenëse implementimi i të drejtave të shumta të pakicave bazohet edhe në nivel lokal, aktet komunale janë me rëndësi të madhe për cilësinë e mbrojtjes së pakicave. Sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale, komuna është e autorizuar për implementimin, mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave individuale dhe kolektive të pakicave. Ajo ka kompetenca të veçanta në përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave, arsimimin dhe mediat në gjuhën e pakicës, në përkrahjen e aktiviteteve kulturore të grupit të pakicës, etj.

Këshillat kombëtare të pakicave kombëtare e paraqesin formën e vet administrimit të pakicave me të cilat pjesëtarët e pakicave përmes përfaqësuesve të vet të zgjedhur ndikojnë në

ruajtjen e identitetit dhe për mbrojtjen e të drejtave, veçanërisht në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit.

Kushtetuta i garanton të drejtat individuale dhe kolektive të pjesëtarëve të pakicave, të cilat të drejtat e veta deri më tani i kanë promovuar dhe mbrojtur vetëm përmes partisë politike, kurse me formimin e këshillave kombëtare u është ofruar edhe një mundësi shtesë, një mekanizëm shtesë për shprehjen dhe mbrojtjen e të drejtave. Pjesëtarët e këshillave kombëtare në Republikën e Serbisë i formojnë dhe i zgjedhin këshillat e veta kombëtare për realizimin e autorizimeve në fushën e:

- **kulturës,**
- **arsimit,**
- **informimit dhe**
- **përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit.**

Këshilli kombëtar e përfaqëson pakicën kombëtare në fushën e autonomisë kulturore dhe si formë e vetorganizimit të bashkësive të pakicave, e siguron dhe e institucionalizon pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes dhe të administrimit për të gjitha çështjet në këto fusha.

Pas kësaj strukture të parashikuar me ligj, raporti përqendrohet në vizionin e parapërcaktuar për funksionimin e këtij institucioni, masat dhe veprimet e ndërmarra si dhe fushat që janë nën autorizimin e tij .

Qëllimi dhe fushëveprimi

KKSH ka për synimin e krijimit të bashkëpunimit për qasje të përbashkët në politikat, programet dhe iniciativat rajonale. Nxitjen e politikave, nismave të përbashkëta, krijimit të përkrahjes së përbashkët të aktiviteteve dhe politikave për sferat e fushëveprimit të tij.

- Mbrojtja, ruajtja dhe avancimi i identitetit kombëtar
- Ndërtimi si institucion i respektueshëm vendor e ndërkombëtar
- Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës
- Hapja e zyrave në komunat e Preshevës dhe Mevdegjës
- Hartimi i strategjisë së përgjithshme dhe sektoriale.

Objektivat

KKSH ka nxitë veprime të përbashkëta dhe ka inkurajuar bashkëpunimin në fushat me interes:

- KKSH është në mision për t'i tejkaluar pengesat në arsim, kulturë, informim dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, e që janë pengesë për zhvillimin e tërësishëm të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.
- Ka synuar përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, si dhe përmbushjen dhe artikullimin e nevojave dhe interesave të tyre. Përcaktimi strategjik në veçanti, paraqet njohjen e rolit të Këshillit Nacional Shqiptar në proceset e orientuara kah zhvillimi i gjithmbarshëm, si forcë institucionale lëvizëse dhe promotor i vlerave të shoqërisë.
- KKSH ka ndërmarrë përgjegjësitë që i takojnë dhe ka vendos për të gjitha çështjet që i takojnë, në të gjitha nivelet e zhvillimit të shoqërisë.
- Zhvillimi dhe forcimi i mekanizmave institucional si dhe i shoqërisë civile, shoqatave arsimore e kulturore, konsideron si hap të domosdoshëm për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi dhe garanci për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.
- KKSH ka nxit rritjen e cilësisë së jetës, të edukimit, kulturës, informimit e përdorimit të gjuhës institucionalisht. Ka nxit ripërtëritjen morale përmes shkollës, vlerësimit të punës, respektit për të drejtat e liritë individuale e kolektive. Ka nxit kulturën si kujtesë e parafytyrim duke krijuar një klimë të favorshme për çdo talent dhe energji krijuese.
- Futjen në veprim të potencialeve krijuese, të iniciativave dhe të invencionit, pjesëmarrjen dhe integrimin në procesin këtij institucioni duke u mbështetur në vlerat dhe principet demokratike, si dhe përfaqësimin adekuat në institucionet shoqërore, politike e publike;
- Promovimin dhe kultivimin e klimës së mirëkuptimit dhe tolerancës ndërnjerëzore, si parakusht i rëndësishëm për krijimin e rrethanave të stabilitetit dhe unitetit;
- Sigurimin e kushteve më të volitshme për shkollim, për studime dhe ngritje profesionale, sigurimin e bursave dhe mbështetjeve të tjera për shkollimin e gjeneratës së re;

REALIZIMI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Në sistemin normativ dhe institucional të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë, KKSH njihen si organe për ushtrimin e autonomisë kulturore. Që nga themelimi i tij në vitin 2010, KKSH përpiqet t'i përgjigjet sfidave në fushën e arsimit, kulturës, informimit dhe përdorimit zyrtarë të gjuhës në përputhje me kompetencat publike të përcaktuara në Ligjin mbi këshillat kombëtare të pakicave kombëtare.

Më vitin 2010 është bërë konstituimi i parë, themelimi Këshilli Kombëtar Shqiptar (në tekstin e më tejme Këshilli), në mënyrë që të realizojnë të drejtat në kulturë, arsim, informim dhe përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip. Këshilli Kombëtar Shqiptar kishte 29 anëtarë. Pas zgjedhjeve demokratike të mbajtura me 26 tetor 2014, në Këshillin kombëtar shqiptar përbërja e re është konstituuar me datë 24 nëntor 2015. Numëron gjithsej 15 anëtarë, kryetarin e Këshillit, Organin ekzekutiv dhe gjashtë komisione. Zgjedhjet e fundit demokratike janë mbajtura më 4 Tetor 2018, ndërkaq është konstituuar me përbërjen e re më 26 Nëntor 2018 edhe ate Këshilli Ekzekutiv, Këshillat për arsim, kulturë, informim dhe përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip.

Nga zgjedhjet e vitit 2018 mosha mesatare e anëtarëve KKSH-së është 37 vjet. Nga gjithsej 15 anëtarë, 10 i përkasin dy kategorive të të rinjve (66,7%), saktësisht, 4 anëtarë kanë prej 18 deri 30 vjet, kurse 6 anëtarë kanë prej 30 deri 35 vjet.³ Ky fakt tregon se KKSH ka përfshirë rininë në punën e saj. Në pikëpamje të strukturës gjinore të këshillit, jashtëzakonisht pak gra janë të përfshira në punën e KKSH-së, gjithsej 4 gra nga gjithsej 15 anëtarë të këshillit (37,5%).⁴

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar (KKSH) bashkërisht me organet përkatëse dhe me bashlëpunëtorët profesional, punën e vet gjatë kësaj periudhe kryesisht e kanë realizuar në selinë e Këshillit Kombëtar Shqiptar. Ndërkaq, për arsye objektive në disa raste mbledhjet e nën komisioneve janë mbajtur edhe në vende të tjera sipas nevojës.

Janë përpunuar nga Shërbimi profesional rreth 400 lëndë për vitin 2019 të evidentuara në regjistrin e arkivës së KKSH-ës, ndërkaq njoftime, kumtesa, intervista dhe deklarata mbi 80 janë lëshuar dhe botuar në media të ndryshme po nga ky shërbim.

KKSH është përcaktuar në realizimin e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, dhe mundësisë së trajtimit dhe zigjdhjen e çështjes së Luginës së Preshevës. Bashkëpunim i ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Parlamentin e Kosovës, bashkëpunim të

³Analizë mbi përfshirjen e të rinjve bë punën dhe aktivitetet e këshillave kombëtare të pakicave kombëtare, CeSID, 2019. <https://bit.ly/2ntBuNk>

⁴Në fushatën për zgjedhje të KKSH-së të gjitha listat kanë respektuar dispozitën e ligjit sipas të cilës çdo person i tretë në listë duhet të jetë person i gjinisë më pak të përfaqësuar, në këtë rast ato janë gratë. Pas zgjedhjeve, me rastin e vendosjes së anëtarëve të këshillit, gratë të cilat ishin në listë heqin dorë nga anëtarësia në këshill në favor të burrave.

sinqertë me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë – në veçanti me Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe Ministrin e Arsimit për të gjetur zgjidhje adekuate për problemet e Luginës së Preshevës. Gjithashtu, konfrontim i hapur me institucionet e Republikës së Serbisë e cila edhe më tej neglizhon kërkesat e tona legjitime tashmë të ofruara edhe me dokumente konkrete. Në përmasimin e pozitës së komunitetit shqiptar sigurisht një rol qenësor ka edhe Bashkësia Ndërkombëtare. Por, nuk kemi pushur në përpjekjet tona me të gjitha palët e interesuar për të gjetë zgjidhje edhe teksteve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe si dhe problemeve tjera konkrete. Por, para nesh mbete shumë punë dhe na duhet ndihmë edhe më e madhe rajonale në mënyrë që sa do pak për të përmisuar gjendjen e rëndë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Mund të theksohet konkretisht:

- Ka referuar për herë të parë në takimin e grupit jo formal të Ambasadorëve “Miq e Luginës” për pozitën e shqiptarëve në Luginën e Preshevës.
- Ka referuar para Komisionit për Barazi dhe Mos-diskriminim pranë Këshillit të Evropës me seli në Strasburg të Francës, ka marrë pjesë në takimin e Nënkomisionit të të Drejtave të Pakicave të Asamblesë parlamentare të Këshillit Evropës.
- Për herë të parë është vendosur mënyra e financimit të rregullt edhe nga Republika e Shqipërisë dhe jemi në proces për eksplorimin e mundësisë edhe nga Republika e Kosovës.
- Ka nisur iniciativën për hapjen e Konzulatës të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Luginën e Preshevës.
- Ka nisur iniciativën për Momerandumin e Mirëkuptimit me Ministrisë së Arsimit të Republikë së Serbisë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë.
- KKSH ka mbrojtur qëndrimin mbi mos ndryshimin e flamurit kombëtar,
- Ka nisur iniciativën e bashkëpunimit me Këshillin Kombëtar të shqiptarëve në Malin e Zi. Iniciativë për Momerandum Bashkpunimi.
- Ka intensifikuar bashkëpunimin me zyrën e OSBE-së për Luginë të Preshevës, si dhe misionin e OSBE-së në Serbi me projekte konkrete.
- ka përpiluar “Planin Strategjik 2020-2025” gjithpërfshirës e sektorial,

- Aktivisht i angazhuar në për përpilimin e “Katalogut e emrave dhe mbiemra më të shpeshtë në drejtë shkrimin cirilik dhe shqip”.
- Ka realizuar një mori takimesh me ambasador të akredituar në Beograd. Ka marrë pjesë në takime të rëndësishme me digasteret e Qeverisë Gjermane ku janë dorzuar raporte konkrete dhe me Diasporën e Luginës së Preshevës.
- Ka nisur proces gjyqësorë ndaj Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Serbisë për përdorim të gjuhës së urrejtjes.
- Ka iniciuar Hapjen e zyreve të KSSH-ës në komunën e Preshevës dhe Medvegjës (ende nuk është realizuar për shkaqe politike)
- Ka hartuar standardet, Planë programet për klasën e 2,3,4,5,6,7 dhe 8 si dhe për shkollat e mesme 1,2 për gjuhën shqipe si detyrim ligjor.
- Ka dhënë mendimin në procesin e zgjedhjes së drejtorëve në shkollat me mësim në gjuhën shqipe
- Ka dhënë mendimin në procesin e konkursit për projektet e kulturës nga Ministria Kulturës dhe Informimit të Republikës së Serbisë.
- Ka dhënë mendimin në procesin e konkursit për projektet e informimit nga Ministria Kulturës dhe Informimit të Republikës së Serbisë.
- Është në proces të ofrimit të gjithë dokumentacionit shkollor në gjuhën shqipe.
- Është angazhuar në përpilimin e testeve përfundimtare të nevojshme sipas domosdoshmërisë ligjore.
- Ka hartuar raporte të veçanta si “Mungesa e Teksteve Mësimore – në proces për vite” dhe “Përfaqësimi i shqiptarëve nga procesi elektoral.
- Është pjesë e Kordinimit të Këshillave kombëtare të pakicave nacionale
- Është pjesë e Këshillit Republikan të këshillave kombëtare të pakicave nacionale

KULTURA

Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i kulturës dhe traditës, është një nga të drejtat e pamohueshme të pjesëtarëve të pakicave kombëtare të cilat, për avancimin e kulturës dhe të traditës së vet, mund të themelojnë institucione të veçanta kulturore, artistike dhe shkencore, shoqëri dhe shoqata të ndryshme. Në pajtim me mundësitë e veta, vetëqeverisjet vendore duhet të ndihmojnë punën e institucioneve dhe të shoqërive në fjalë. Gjithashtu, vetëqeverisjet vendore, duhet të kenë obligim të mbrojnë të mirat kulturore me rëndësi për komunën, të nxisin zhvillimin e krijimtarisë kulturore dhe artistike, të sigurojnë mjetet për financim dhe bashkëfinancim të programit dhe të projekteve në fushën e kulturës, të krijojnë kushte për punën e institucioneve të ndryshme.

Korniza juridike dhe iniciativat e ndërmarra

Mirëmbajtja e kulturës kombëtare u takon elementeve qendrore të mbrojtjes së identitetit kombëtar të pakicave kombëtare. Për këtë arsye e drejta për të nxitur traditën dhe kulturën e vet përgjithësisht, është pranuar si standard në mbrojtjen e pakicave dhe është e garantuar në tekstet juridike ndërkombëtare dhe të vendit.

Sipas nenit 79, të Kushtetutës së Republikës së Serbisë, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin, të ruajnë, të kultivojnë, të zhvillojnë dhe publikisht të shprehin veçantitë kombëtare, etnike, kulturore dhe religjioze. Konventat orientuese i obligojnë shtetet në nenin 5.1. që të përparojnë kushtet e nevojshme për pjesëtarët e pakicave kombëtare që të mbajnë dhe të zhvillojnë kulturën e vet, si edhe ruajtjen e elementeve të domosdoshme të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditën dhe trashëgiminë kulturore. Karta e rregullon çështjen e kulturës në nenin 12.

Aktivitetet kulturore të KKSH-ës e përfshijnë mbrojtjen e të mirave kulturore, zhvillimin e veprimtarisë kulturore dhe objektet me rëndësi për zhvillimin e kulturës veçanërisht bibliotekës, organizimin dhe themelimin qendrës multidimensionale kulturore, arkivat, akademitë përkujtimore, teatrot e kinematë, si edhe krijimtarinë letrare, format e të shprehurit kulturor, festivalet dhe industria kulturore, duke përfshirë midis tjerash edhe përdorimin e teknologjive të reja. Gjithashtu ka realizuar në bashkëpunim Qendrën Kinematografike të Kosovës dhe Nagip Tashin edhe projektin “Java e filmit Kosovar”.

KKSH ka ndërmarrë masa: ka inkurajuar format e të shprehurit dhe nismat e veçanta për gjuhën shqipe dhe ka kultivuar mënyrat e ndryshme të trajtimit të veprave të prodhuara në gjuhën shqipe, ka nxitë përmes mjeteve të ndryshme punimet e krijuara në gjuhën shqipe duke ndihmuar dhe zhvilluar përkthimin; ka inkurajuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve përdorues të gjuhës shqipe për sigurimin e kushteve për planifikimin e veprimtarive kulturore.

Ligji për pakicat kombëtare i garanton të drejtat në pikëpamje të ruajtjes së kulturës së komunitetit shqiptar. Ligji e garanton të drejtën për shprehjen, ruajtjen, zhvillimin, dhe bartjen e kulturës, dhe e identifikon këtë të drejtë, si të drejtë individuale dhe kolektive (neni 12.1). Gjithashtu ai e parashikon themelimin e objekteve kulturore-artistike dhe shkencore (neni 12.2) me çrast KKSH ka nisur iniciativën për themelimin e Entit për Kulturë Shqiptare si dhe ka ndërmarrë iniciativën për krijimin e platformës digjitale – Muzeu digjital. Për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore-historike të komunitetit shqiptar në Luginë të Preshevë. Njëkohësisht ka kërkuar nga Enti për mbrojtjen e monumenteve të siguroi dhe dorëzoi lapidarin me emrat e dëshmorëve të rënë të UÇPMB-ës që ishte larguar me dhunë.

Kompetencat ligjore të Këshillit

Ligji për këshillat e pakicave rregullon kompetencat e KKSH-ës në fushën e kulturës. Neni 16 u jep këshillave të pakicave kombëtare të drejtat themeluese lidhur me themelimin e institucioneve kulturore. Neni 17 i parashikon instrumentet e pjesëmarrjes së këshillave kombëtare në administrimin e institucioneve të kulturës. Neni 18 i përfshin 12 kompetenca të ndryshme të këshillit të pakicave kombëtare të cilat kanë të bëjnë me institucionet, manifestimet, dhe objektet me interes të veçantë për pakicat kombëtare (neni 18.1, 18.3, 18.4), strategjitë kulturore të pakicave kombëtare (neni 18.2), ruajtjen dhe përtëritjen e përmbajtjeve kulturore (neni 18.5), planet hapësinore dhe urbanistike (neni 18,6 dhe 18,7), qarkullimi dhe ruajtja e të mirave të luajtshme dhe të paluajtshme kulturore (neni 18.8), bibliotekat (neni 18.9), shpërndarjen e mjeteve publike buxhetore institucioneve, manifestimeve dhe shoqatave të kulturës (neni 18.10).

Këshilli kombëtar ka përpiluar strategjinë e zhvillimit të kulturës, është merrë me çështjet e institucioneve dhe të manifestimeve në fushën e kulturës, me përcaktimin dhe mbrojtjen e të drejtave kulturore, bibliotekave, ka ndikuar në ndarjen e mjeteve nga buxheti, -të orientuara për këtë fushë nga institucionet republikane.

Të gjitha manifestime kulturore si ekspozitat, shfaqjet teatrale, promovimi i librave, manifestimet tradicionale të këngës dhe valles shqipe të organizuara në Komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës janë përcjellur, janë ndihmuar dhe do të ndihmohen.

ARSIMI

Sistemi arsimor pritet që individit t'i ofrojë njohuritë të cilat do ta bëjnë pjesëmarrës më kompetitiv në treg, por gjithashtu edhe t'i kontribuojë ruajtjes së kulturës dhe identitetit kombëtar. Sistemi arsimor, duhet të jetë i hapur ndaj realitetit etnokulturor dhe nevojave të ekonomisë dhe të shoqërisë, ndërmjetësojë njohuritë dhe përmbajtjet të cilat janë të rëndësishme edhe për ruajtjen e identitetit kombëtar, por edhe për pozitën e tyre dhe shanset në treg.

E drejta për arsimimin, është bazuar në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, Kartë e të drejtave, Konventën kornizë, Ligjin për pakicat kombëtare, Ligjin për këshillat e pakicave kombëtare si dhe me ligjet e ndryshme të cilat e rregullojnë fushën e arsimit (Ligji për shkollën fillore, Ligji për shkollën e mesme, Ligji për arsimin e lartë, etj.).

Korniza juridike dhe iniciativat e ndërrmara

Sipas Kushtetutës së Serbisë, secili ka të drejtë për arsimim (neni 71.1). Pjesëtarët e pakicave kombëtare mund të ndjekin mësimin në institucionet arsimore dhe në këtë vështrim nuk mund të jenë të diskriminuar në kurrfarë mënyre. Krahas trajtimit të përgjithshëm në sistemin arsimor të Serbisë, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë për arsimim në gjuhën e vet në institucionet shtetërore dhe krahinore dhe të drejtë për themelimin e institucioneve private arsimore (neni 79.1).

Obligimet ndërkombëtare të Serbisë në pikëpamje të arsimimit të pakicave rezultojnë nga Konventat kornizë (nenet 12-14) dhe Kartat (neni 8). Konventa kornizë e rregullon të drejtën për arsim në gjuhën e pakicave në nenin 14. Kjo u garanton pjesëtarëve të pakicave kombëtare të drejtën të mësojnë gjuhën e vet. Neni 14.2 flet për të drejtën e individit të mësojë gjuhën e pakicës, ose të drejtën të shkollohet në gjuhën e pakicës në kuadër të sistemit arsimor të shtetit.

Neni 12 i Konventës kornizë ka për qëllim të krijojë shoqërinë tolerante interkulturore. Neni 13 e rregullon të drejtën e pakicave kombëtare për themelimin dhe zhvillimin e institucioneve të veta shtetërore e private për arsim dhe aftësim. Këto institucione janë pjesë përbërëse të sistemit arsimor të shtetit. Në këtë vështrim shteti duhet të pranojë diplomat dhe dokumentet tjera të

lëshuara nga ana e këtyre objekteve.

Karta përmban në nenin 8 listën e masave në pikëpamje të arsimit. Këto masa i përfshijnë të gjitha nivelet e procesit arsimor. Serbia ka pranuar të ketë në disponim arsimin parashkollor për gjuhët e pakicave, ose të mundësojë një pjesë të konsiderueshme të arsimit parashkollor në gjuhën e pakicave, së paku për ata fillestarë familjet e të cilëve e kërkojnë këtë dhe numri i të cilëve konsiderohet i mjaftueshëm, ose nëse pushteti qëndror nuk ka autorizime të drejtpërdrejta në fushën e edukimit dhe të arsimit parashkollor të stimulojë ose inkurajojë aplikimin e këtyre masave (neni 8.1.a (iii) dhe (IV)).

Gjithashtu Serbia ka pranuar të mundësojë kushtet për studimin e gjuhëve rajonale dhe të pakicave në universitet dhe në shkolla të larta (neni 8.1 E (II)), nëse pushteti lokal nuk ka autorizime të drejtpërdrejta në fushën e arsimit të të rriturve, të stimulojë ose inkurajojë ofertën e gjuhëve të tilla si lëndë të arsimimit të të rriturve (neni 8.1 F (III)), dhe të krijojë programet të cilat do të siguronin mësimin e historisë dhe të kulturës e cila pasqyrohet nga ana e gjuhëve rajonale ose e pakicave (neni 8.1 G).

Ligji për pakicat kombëtare e rregullon çështjen e arsimit. Ligji e garanton të drejtën e pjesëtarëve të pakicës shqiptare kombëtare për arsimim në gjuhën e pakicave në institucionin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm (neni 13.1). Arsimimi në gjuhën e pakicës nuk përjashton obligimin që të mos mësohet gjuha serbe (neni 13.4). Ligji jep disa udhëzime të programit, ku programet për arsim në gjuhën e pakicës do të përfshijnë çështjet e historisë, artit dhe të kulturës së pakicave kombëtare (neni 13.5). Gjithashtu, plani dhe programi mësimor në shkolla, ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, duhet të promovojnë tolerancën dhe koherencën (neni 13.7).

Neni 14 rregullon aspektet e ndryshme të arsimit dhe trajnimit e arsimtarëve për arsim në gjuhët e pakicave. Neni 15 lejon që personat të cilët i takojnë pakicës kombëtare të themelojnë dhe të mirëmbajnë institucione private të arsimit.

Ligji për arsim i rregullon çështjet e ndryshme për arsimin e pakicave. Sipas nenit 4.1 pika 14 një nga qëllimet e arsimit, ndër të tjera, është edhe zhvillimi i identitetit personal dhe kombëtar, zhvillimi i ndjenjës së përkatësisë, respektimi dhe kultivimi i gjuhës amtare, traditës dhe kulturës, pakicave kombëtare dhe bashkësive etnike, zhvillimi i multikulturalizmit, respektimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe botërore. Qëllimi i cili është theksuar në pikën 15, ndër të tjera e përfshin zhvillimin dhe respektimin e barazisë kombëtare, kulturore, gjuhësore dhe fetare, tolerancën dhe respektimin e diversiteteve. Sipas nenit 9.2 të këtij ligji për pjesëtarët e pakicave kombëtare arsimit ofrohet në gjuhën amtare. Në raste të jashtëzakonshme, arsimit mund të ofrohet në dy gjuhë ose në gjuhën serbe, në pajtim me ligjin e veçantë. Neni 74 i Ligjit e rregullon përmbajtjen e planeve dhe të programeve në shkollën fillore dhe të mesme i cili do të duhej, ndër të tjera, të mbulojë mënyrën e rekomanduar të përshtatjes së planeve dhe të programeve për

lëndët me rëndësi të pakicave kombëtare dhe programet e arsimit në dy gjuhë (neni 74.4). Ministri i Arsimit është i autorizuar të aprovojë planin dhe programin mësimor për arsimin fillor dhe të mesëm të pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Ministri e aprovon miratimin e këtyre programeve në bazë të rekomandimit të Këshillit të pakicave kombëtare të një pakice të caktuar kombëtare dhe në bazë të mendimit të Këshillit Arsimitor Kombëtar (neni 79.4).

Në pajtim me nenin 5 të Ligjit për arsimin fillor, për pjesëtarë të pakicave kombëtare mësimi gjithashtu ofrohet në gjuhën e tyre amtare, ose në dy gjuhë, nëse më së paku 15 nxënës paraqiten për regjistrim në klasën e parë. Mirëpo, bashkë me pëlqimin e Ministrit të Arsimit, shkolla mund të ofrojë mësimin në gjuhën e pakicës edhe nëse numri i nxënësve është më i vogël se 15. Nëse mësimi është ofruar në gjuhën e pakicës, lënda e gjuhës serbe duhet të mësohet. Nëse mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, nxënësit pjesëtarë të pakicave kombëtare mësojnë lëndën e gjuhës amtare me elementet e kulturës kombëtare. Ligji ka caktuar disa çështje organizative në nenin 25.5., 25.6, nenin 26.2, dhe nenin 69.2. Nëse mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës, në shkollë evidenca mbahet në të dy gjuhët: në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicave (neni 129.2). Njësoj vlen edhe për dokumentacionin e shkollës (neni 134.4). Normat ekuivalente mund të gjenden në Ligjin për arsimin e mesëm shkollor.

Sipas nenit 80.2 të Ligjit për arsimin e lartë, institucionet e shkollimit të lartë mund të organizojnë hulumtime apo të bëjnë studime ose të hapin paralele për studime në gjuhët e pakicave në pajtim me statutin e tij. Gjithashtu Ligji ofron programin në gjuhën e pakicës, nëse për këtë është i autorizuar (neni 80.3). Ligji e parasheh se nëse ofrohet arsimit në gjuhën e pakicës, përfaqësuesi i pakicës kombëtare mund të marrë pjesë në punën e Këshillit Kombëtar për Arsim të Lartë me të drejtë vote (neni 10.3). Në institucione të larta shkollore të cilat janë themeluar nga ana e shtetit e në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës, Këshilli i pakicave kombëtare, jep mendimin për kandidatët për Këshillin e institucionit (neni 52.2). Njësoj vlen edhe për organet ekzekutive të institucionit (neni 54.4). Regjistrat dhe certifikatat janë në dy gjuhë (neni 97.3 dhe neni 99.4).

SHKOLLIMI I KOMUNITETIT SHQIPTAR

Në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, nuk duhet nënvlerësuar rëndësia e arsimit në gjuhën shqipe. Sistemi i arsimit pritet të sigurojë individin me njohuritë që do ta bëjnë pjesëmarrës më të denjë për shoqërinë, por gjithashtu do të kontribuojnë në ruajtjen e kulturës dhe identitetit të pakicave. Kjo detyrë do të arrihet më lehtë nëse pakicat mund të arsimohen, së pari në gjuhën e tyre, dhe atëherë kur integrohet në procesin arsimor historia, kultura dhe tradita

e tyre. Kështu, sistemi arsimor duhet të jetë i hapur ndaj realitetit etnokulturor dhe nevojave të ekonomisë dhe shoqërisë. Gjithashtu të ndërmjetësojë njohurinë dhe përmbajtjen, si të rëndësishme për ruajtjen e identitetit të anëtarëve të pakicave, si dhe pozicionin dhe shanset e tyre në treg.

Sipas legjislacionit të Republikës së Serbisë, të gjithë personat në Serbi, kanë të drejtën e kualifikimit të barabartë. Ekzistojnë ligje të veçanta për të siguruar që komunitetet pakicë të gëzojnë, përveç kërkesave të tjera, qasjes së plotë në arsim në gjuhën e tyre, me qëllim që të ofrojnë mundësi të barabarta në raport me shumicën. Megjithatë, përkundër bazës së fortë ligjore, nxënësit nga komunitetet pakicë, veçanërisht shqiptarët, vazhdojnë të përballen me sfida të rëndësishme në arsimimin e tyre.

Sipas raportit vjetor të KSSH-së për vitin 2017, sfida më e madhe gjatë viteve është sigurimi i teksteve shkollore, në gjuhën shqipe, për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme.

Deri më tani është dëgjuar se janë ofruar "66 libra për shkollat fillore, të cilat janë të lejuara për publikim, prej të cilave 18 tekste dhe fletore pune nga Shqipëria, 10 tekste dhe fletore pune nga autorë lokalë dhe 38 tekste dhe fletore të përkthyer, Nga këto 15 tekste e gjuhëve të huaja janë të pranueshme për të gjitha minoritetet në Serbi. ". Nga ana tjetër, nuk kemi arritur përfshirjen e kulturës, identitetit dhe historisë së komunitetit shqiptar (deri në 30%) në kurrikulën për lëndët: histori, art figurativ dhe kulturë muzikore.

Indikatorët për të vlerësuar disponueshmërisë, aksesueshmëria, pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë e arsimit sipas Kornizës 4A⁵ thekson që "Shtetet duhet të sigurojnë që arsimit të jetë në të njëjtën masë i pranueshëm për të gjithë, duke shmangur dhe / ose hequr pengesat fizike, ekonomike, administrative dhe socio-ekonomike për të siguruar grupet e marginalizuara që të mundën të ndjekin shkollimin. Arsimit i tyre duhet të jetë i një cilësie të mirë dhe të jetë i pranueshëm në aspektin e gjuhës, participim dhe fesë, dhe gjithashtu duhet të përshtatet me ato kategori, që janë veçanërisht të cenueshme, siç janë pakicat etnike dhe personat me aftësi të kufizuara ".

Zbatimi i Kuadrit 4A, mundëson dhënien e një pasqyre të plotë të shtetit dhe / ose realizimin e së drejtës për arsim për grupet e marginalizuara dhe grupet e cenueshme nga diskriminimi.

Sipas Kushtetutës së Serbisë, secili ka të drejtën e arsimit (neni 71 paragrafi 1). Anëtarët e pakicave kombëtare duhet të kenë qasje në institucionet arsimore dhe në këtë kuptim nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë. Përveç qasjes së përgjithshme në sistemin arsimor të Serbisë, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën e arsimit në gjuhën e tyre në institucionet

⁵ Kjo kornizë u zhvillua nga Katarina Tomasevski, ish Raportuese Speciale e OKB-së për të drejtën e arsimit, e më pas e përdorur nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në sqarimin e bazës së saj normative për nenin 13.

Kuadri 4A kërkon që arsimit të jetë i përgjithshëm, pengesat në akses duhet të hiqen, përmbajtja e tij duhet të jetë e pranueshme dhe se arsimit duhet të përshtatet me grupe të veçanta dhe nevoja sociale.

Për shkak se ndalimi i diskriminimit bazohet në të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Kuadri 4A duhet të vlerësohet me një fokus të veçantë në grupet e marginalizuara dhe prekurit nga diskriminimit.

shtetërore dhe krahinore, të drejtën për të themeluar institucionet arsimore private (neni 79 paragrafi 1).

Obligimet ndërkombëtare të Serbisë, në lidhje me edukimin e pakicave, rrjedhin nga Konventa Kuadër për të Drejtat e Pakicave Kombëtare (nenet 12-14) dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (Neni 8). Konventa Kornizë rregullon të drejtën për arsimim në gjuhën e pakicave në Nenin 14, që u garanton pjesëtarëve të pakicave kombëtare të drejtën për të mësuar gjuhën e tyre. Neni 14, paragrafi 2, flet për të drejtën e një individi për të mësuar gjuhën e pakicës ose të drejtën për të marrë arsimimin në gjuhët minoritare, brenda sistemit arsimor shtetëror.

Më 28 shkurt 2018 kemi marrë Letrën e 15 Ambasadorëve, që ka inkurajuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik dhe Këshillin Kombëtar Shqiptar për të siguruar tekstet shkollore për shkollat fillore, me mësim në gjuhën shqipe, nëpërmjet Memorandumit Trepalësh, që ofron përkthimin në fillimin e vitit shkollor. Dhe asgjë nuk ndodhi.

Tekstet në gjuhën shqipe

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtën e arsimit në gjuhën e tyre, në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm (neni 13), është nënvizuar me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare. Ligji për tekstet shkollore (neni 5) thotë se *tekstet në gjuhën dhe shkrimin e një pakice kombëtare konsiderohen: 1) teksti në gjuhën dhe shkrimin e një pakice kombëtare të lëshuar në territorin e Republikës së Serbisë; 2) teksti në gjuhën dhe shkrimin e një pakice kombëtare që është teksti i përkthyer e i miratuar në Serbi; 3) shtojca në tekstin shkollor të përdorur për zbatimin e një programi të mësimdhënies dhe mësim nxënies, të përshtatur për lëndët me rëndësi për një pakicë kombëtare; 4) teksti në gjuhën dhe shkrimin e një pakice kombëtare të lëshuar në një vend të huaj, të miratuar në përputhje me këtë ligj.*

Dispozitat e këtij ligji në lidhje me tekstin mësimor zbatohen edhe për shtojcën e përmendur në paragrafin 1 pika 3 të këtij neni për nenet me rëndësi, për pakicën kombëtare.

Sidoqoftë, në vitin 2018, në bashkëpunim me Shtëpinë botuese "Albas" nga Tirana dega në Preshevë, në Republikën e Shqipërisë, ka arritur të ofrojë pesë tekstet shkollore në gjuhën shqipe, si në vijim:

- "Edukimi i artit figurativ 1", Shtëpia botuese "Albas" ShPK Tiranë 2010, me autorin Ledija Konstandini;

- "Edukimi i artit figurativ 2", Shtëpia botuese "Albas" ShPK Tiranë 2009, me autorin Ledija Konstandini; -
 - "Edukimi i artit figurativ 3", Shtëpia botuese "Albas" ShPK Tiranë 2009, me autorin Ledija Konstandini;
 - "Abetare", Shtëpia botuese "Albas" ShPK Tiranë, me autorin Rita Petro, Mirela Forrova, Natasha Pepivani, Flutura Çitaku dhe Vehbi Kadriu;
 - "Dituri natyre 1", Shtëpia botuese "Albas" ShPK Tiranë 2012, nga autori Anthony Russell;
- Gjithashtu, të njëjtat tekste janë të listuara në Katalogun e teksteve shkollore në gjuhët e pakicave, të botuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Serbisë.

Mungesa e teksteve shkollore

Mungesa e teksteve shkollore në gjuhën shqipe. Kjo çështje ka të bëjë me çështjen e kurrikulave dhe planprogramet shkollore. Megjithatë, sa i përket teksteve shkollore, mund të vërehet mungesa e plotë e trajtimit sistematik. Për vite me radhë nuk ka tekste shkollore në gjuhën shqipe që janë botuar për nxënësit e komunitetit shqiptar dhe tekstet e botuara në mesin e viteve 1990 nuk u përgjigjen nevojave të veçanta të arsimit në gjuhën shqipe. Por ka përkthime të teksteve shkollore nga gjuha serbe dhe pas shumë reformave në arsim të pa përshtatshëm. Megjithëse sistemi ligjor i Serbisë njeh mundësinë e importimit të teksteve shkollore në gjuhën e pakicës, zbatimi i kësaj mundësie nuk arrihet lehtë. Edhe pse mënyra më e lehtë është importimi i teksteve shkollore nga Shqipëria apo Kosova, apo edhe nga Maqedonia. Ky nuk duhet të jetë mekanizmi i vetëm për avancimin e arsimit për komunitetin shqiptar. Duhet të bëhen përpjekje që në periudha afatgjata të punojnë për të shtypur tekstet në gjuhën shqipe edhe në Serbi, të cilat duhet të kontribuojnë në zhvillimin e aspektit multikulturor e integrues dhe mbi të gjitha, të hartohen sipas planprogrameve të parapara.

Ka nevojë për të përmirësuar bibliotekat shkollore dhe për të siguruar materiale të tjera të punës, që janë thelbësore në mësim nxënien e rregullt (harta gjeografike dhe historike, globet, video dhe audio bibliotekat, kompjuterë etj.).

Tekstet shkollore, që mungojnë sipas Memorandumit të bashkëpunimit në çështjen e teksteve në gjuhën shqipe. Numri: 680-00-88 / 2016-06, Data: 08.08.2016

Tekstet e miratuara më parë në gjuhën serbe, që duhet të përgatiten si përkthim në gjuhën shqipe.

Tekstet, të cilat fillimisht duhet të përgatiten në gjuhën shqipe sipas Memorandumit

- 1) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e parë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 2) Shtesa e konsoliduar e teksteve për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e dytë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 3) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e tretë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 4) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e katërt të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 5) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e pestë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 6) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e gjashtë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 7) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e shtatë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare
- 8) Shtesa të konsoliduar në tekstet shkollore për kulturën e muzikës dhe artit figurativ për klasën e tetë të shkollës fillore - përmbajtje me rëndësi për pakicën kombëtare shqiptare

Tekstet 2019

Tekstet, që janë të përshtatshme për përdorim, kohët e fundit (2019) për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik janë: Nga Shtëpia botuese “Albas” 12 tekste shkollore dhe 5 fletore pune, si dhe 5 tekste shkollore në procesin e aprovimit nga Ministria; Mund të përdoren 6 tekste shkollore, ndërkaq dhe 4 tekste shkollore dhe 4 fletore pune në procesin e aprovimit nga Ministria nga Shtëpia botuese “Qendra Kreative”; Nga shtëpia botuese Zavod za Udzbenike (Enti për botime) janë 14 tekstet shkollore. të përshtatshme për përdorim dhe 6 fletore pune dhe asnjë në procesin e miratimit nga Ministria. Shih tabelat, si më poshtë.

Vlen të theksohet, se gjatë mbledhjes së të gjitha teksteve shkollore për shkollat fillore dhe të mesme, për vitin 2019 janë 32 tekste shkollore për 27 lëndë të shkollës fillore nga më se 109 lëndë (83 lëndë obligative, 24 lëndë obligative zgjedhore dhe 2 lëndë zgjedhore për vitin

2018/2019) dhe asnjë për shkollën e mesme, megjithëse mund të konstatohet se një numër i konsiderueshëm i teksteve mësimore për të njëjtat lëndë.

Pasqyrimi i institucioneve arsimore

në komunat Bujanoc , Preshevë dhe Medvegjë :

Në Preshevë dhe Bujanoc, pjesëtarët e komuniteteve shqiptare dhe serbe, bëjnë jetë paralele në shkolla të ndara, me pak miqësi të ndërsjellë dhe ndërveprim.

Arsimi në gjuhën shqipe është një nga segmentet kryesore për komunitetin shqiptar. Tiparet kryesore të këtij sistemi janë ekzistenca e institucioneve: parashkollor, fillor dhe të mesëm, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa në aspektin e arsimit të lartë kemi ende probleme.

Në territorin e **komunës së Bujanocit** ka 10 shkolla fillore, dy shkolla të mesme dhe një shkollë fillore për arsim dhe edukim muzikor.

Shkollat, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën serbe janë: " Branko Radoviq" në Bujanoc, "Borovo Stankoviq" në fshatin Klenik, "Dragomir Trajkoviq " në fshatin Zhbevc, " Vuk Karadzic" në fshatin Levosoja, Shkolla e mesme " Sveti Sava " në Bujanoc dhe Shkolla fillore për edukim muzikor në Bujanoc.

Shkollat, ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe, "Naim Frashëri" në Bujanoc, "Sami Frashëri" në Lluçan, "Muharrem Kadriu" në Tërrnoc, "Migjeni" në Muhoc, "Ali Bektashi" në Nasalcë, "Desanka Maksimoviq" në Bilaç, Gjimnazi "Sezai Surroi " në Bujanoc dhe enti parashkollor "Gëzimi ynë" me seli në Bujanoc, për të dy komunitetet.

Shkollat e mesme - Shkolla Ekonomike "Sveti Sava" (ekonomi, ligj dhe administratë, inxhinieri mekanike, përpunim metali, tregti, furnizim ushqimi, turizëm, mjekësi dhe mbrojtje sociale, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën serbe).

Dhe "Sezai Surroi" (drejtimi i përgjithshëm i gjimnazit, ekonomisë, drejtësisë dhe administratës, inxhinieri mekanike dhe përpunimit të metaleve, inxhinieri elektrike, tregti, furnizim ushqimi dhe turizëm, mjekësi dhe mbrojtje sociale, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe).

Në **Komunën e Preshevës** është një institucion parashkollor me disa paralele në fshatrat përreth, tetë shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme.

Mësimi në gjuhën shqipe zhvillohet në 6 shkolla fillore, një në gjuhën serbe dhe "9 Maj", në të cilën nxënësit e të dy bashkësive po ndjekin mësimin në të njëjtën godinë dhe mësimet jepet në të dyja gjuhët. Shkollat fillore janë: " Vuk Karaxhiq" dhe "Ibrahim Klemendi" në Preshevë, "Abdullah Krashnica" në fshatin Miratoc, "9 Maji" Leran, "Selami Hallaçi" në fshatin Rahovicë, "Migjeni" në fshatin Caravajkë, " Zenel Hajdini" në fshatin Rincë dhe "Dituria" në Corroticë. Komuna e Preshevës ka dy shkolla të mesme - gjimnazi dhe shkolla teknike, në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe serbe.

Në dy shkolla të mesme, ka paralele në dy gjuhë - në shkollën e mesme "Skënderbe"; dhe në shkollën teknike "Preshevë"; (me drejtime të ekonomisë, drejtësi dhe administratë, inxhinieri mekanike dhe përpunimit të metaleve, drejtimi i trafikut, tregtia, hotelieri dhe turizmi, mjekësia dhe mbrojtja sociale, pylltaria dhe përpunimi i drurit).

Në **Komunën e Medvegjës** është një: enti parashkollor me 13 departamente, 6 shkolla fillore dhe një shkollë të mesme.

Mësimdhënia në pesë shkolla fillore zhvillohet në gjuhën serbe, ndërsa në një shkollë mësimi është dygjuhësh (në shkollën fillore "Sijarinjska Banja").

Në shkollën fillore "Zenel Ajdini" në Medvegjë mësimi mbahet vetëm në gjuhën shqipe. Shkolla e mesme teknike "Nikolla Tesla" ka dy drejtime mësimore: ekonomi, ligj dhe administratë, inxhinieri mekanike dhe metale, tregti dhe furnizim ushqimi dhe mësimdhënie në gjuhën serbe. Në drejtimin ekonomik, mësimi është dygjuhësh në klasat, ku ka numër të mjaftueshëm të nxënësve.

Numri i nxënësve

Në shkollat fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe

Për vitin shkollor 2018/2019 janë 4437 nxënës që ndjekin shkollat fillore dhe 2606 nxënës në shkollat e mesme, në gjuhën shqipe, pra gjithsej 7043 nxënës.

Krahasuar me vitin 2008/2009 ka rënie për shkollat fillore -47.06% dhe një rënie prej -27.13% për shkollat e mesme. Gjithsej ka një rënie prej -41.10% ose 4914 më pak nxënës që ndjekin shkollat për një dekadë.

Krahasuar me 2013/2014 kemi rënie për shkollat fillore -25.55% dhe një ulje prej -27.29% për shkollat e mesme. Gjithsej ka një rënie prej -26.20% ose 2501 më pak nxënës që ndjekin shkollat për pesë vjet.

Për shkollat veç e veç mund të shihni tabelat në vijim:

Institucioni	Vendi	2008/2009 Studentë N.	2018/2019 Studentë N.	Në %	shuma
"IBRAHIM KELMENDI"	Preshevë	2331	1375	-41,01	-956
"ABDULLA KRASHNICA	Miratoc	539	276	-48,79	-263
"9 MAJI"	Leran	658	282	-57,14	-376
"SELAMT HALLAÇI"	Rahovicë	616	338	-45,13	-278
"Dituria"	Cerroticë	440	234	-46,82	-206
"ZENEL HAJDINI"	Raincë	306	179	-41,50	-127
"Migjeni"	Ceravajkë	93	35	-62,37	-58
"Skënderbeu"	Preshevë	982	800	-18,53	-182
"Presheva"	Preshevë	1333	826	-38,03	-507
Komuna e Preshevës		7298	4345	-40,46	-2953
"DESANKA MAKSIMOVIQ"	Bilac	528	262	-50,38	-266
" SAMI FRASHËRI "	Lluçan	547	230	-57,95	-317
"NAIM FRASHËRI"	Bujanoc	487	367	-24,64	-120
" ALI BEKTASHI"	Nesalcë	461	207	-55,10	-254
"MUHARREM KADRIU"	Tërnoc	1088	519	-52,30	-569
" MIGJENI "	Muhoc	250	81	-67,60	-169
"SEZAI SURROI"	Bujanoc	1220	958	-21,48	-262
Komuna e Bujanocit		4581	2624	-42,72	-1957
"BAJA E SIJARINËS"	Sijarinë	35	29	-17,14	-6
"ZENEL HAJDLNL "	Tupallë	1	16	1500,00	15
"JABLLANICA EPËRME"	Medvegjë	1	7	600,00	6
"NIKOLLA TESLLA"	Medvegjë	41	22	-46,34	-19
Komuna e Medvegjës		78	74	-5,13	-4
Shkollat fillore në Luginën		8381	4437	-47,06	-3944

e Preshevës

Shkollat e mesme në

Luginën e Preshevës	3576	2606	-27,13	-970
Total	11957	7043	-41,10	-4914

Institucionit	vendi	2013/2014 Nr. i nxënësve	2018/2019 Nr.i nxënësve	Në %	shuma
"IBRAHIM KELMENDI"	Preshevë	1835	1375	-25,07	-460
"ABDULLA KRASHNICA	Miratoc	277	276	-0,36	-1
"9 MAJI"	Leran	440	282	-35,91	-158
"SELAMT HALLAÇI"	Rahovicë	440	338	-23,18	-102
"Dituria"	Corroticë	339	234	-30,97	-105
"ZENEL HAJDINI"	Raincë	215	179	-16,74	-36
"Migjeni"	Ceravajkë	53	35	-33,96	-18
"Skënderbeu"	Preshevë	958	800	-16,49	-158
"Presheva"	Preshevë	1264	826	-34,65	-438
Komuna e Preshevës		5821	4345	-25,36	-1476
"DESANKA MAKSIMOVIQ"	Bilac	364	262	-28,02	-102
" SAMI FRASHËRI "	Lluçan	336	230	-31,55	-106
"NAIM FRASHËRI"	Bujanoc	367	367	0.00	0
" ALI BEKTASHI"	Nesalcë	318	207	-34,91	-111
"MUHARREM KADRIU"	Tërnoc	787	519	-34,05	-268
" MIGJENI "	Muhoc	132	81	-38,64	-51
"SEZAI SURROI"	Bujanoc	1333	958	-28,13	-375
Komuna e Bujanocit		3637	2624	-27,85	-1013
"BAJA E SIJARINËS"	Sijarinë	28	29	3.57	1
"ZENEL HAJDLNL "	Tupallë	23	16	-30,43	-7
"JABLLANICA EPËRME"	Medvegjë	6	7	16.67	1
"NIKOLLA TESLLA"	Medvegjë	29	22	-24,14	-7
Bashkia e Medvegjës		86	74	-13,95	-12
Shkollat Fillore		5960	4437	-25,55	-1523

në Luginën e Preshevës				
Shkollat e mesme në				
Luginën e Preshevës	3584	2606	-27,29	-978
Total	9544	7043	-26,20	-2501

Mosnjohja e diplomave të Kosovës

Një problem madhor në arsim është mungesa e njohjes së diplomave nga Kosova, pavarësisht faktit se ky problem është përfshirë në Marrëveshjen e Brukselit dhe se Qeveria e Serbisë ka miratuar Dekretin për njohjen e diplomave nga Kosova.

Sistemi arsimor në Luginën e Preshevës zbatohet në përputhje me ligjet që rregullojnë arsimin në Republikën e Serbisë dhe nuk është i harmonizuar me sistemin arsimor në përputhje me standardet evropiane të arsimit sipas Deklaratës së Bolonjës.

Gjetja e një zgjidhjeje të pranueshme për njohjen e të diplomuarve nga Universitetet e Kosovës, sipas Deklaratës së Bolonjës, ku ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive) duhet të njihet asht siç aplikohet brenda zonës së Bashkimit Evropian.

Zgjidhjet e ofruara.

Fillimisht, Diplomat e lëshuara nga UNMIK-u njihen për tregun e punës. Ndërkohë, institucionet e Republikës së Serbisë nuk i kanë njohur diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të Kosovës, përkatësisht institucionet e përkohshme të Kosovës. Por janë pranuar të certifikuara nga UNMIK-u (të vulosur me UNMIK) për tregun e punës. Por si në rastin e parë edhe në rastin e dytë nuk është njohur si një diplomë e vlefshme për vazhdimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Serbisë.

Situata e tillë ka vazhduar deri më 17 shkurt 2008, shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, atëherë nuk njiheshin më fare as për tregun e punës.

Gjatë bisedimeve në Bruksel midis Prishtinës dhe Beogradit, njohja e diplomave nga Universitetet e Republikës së Kosovës ishte gjetur dhe u zbatua nëpërmjet një organizate evropiane SPARK, e cila ndihmoi në barasvlerësimi nga Shoqata e Universiteteve Evropiane në Bruksel. Me të cilin i diplomuari nga Lugina e Preshevës ka fituar të drejtën për të vërtetuar diplomën në një nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Serbisë, sipas një udhëzimi të lëshuar nga Qeveria e Serbisë. (Dekreti për Njohjen e Veçantë dhe Arritjet e Larta dhe Vlerësimin e Programeve të Studimeve të Universiteteve të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, të cilat nuk kryejnë veprimtari sipas rregullave të Republikës së Serbisë "Gazeta Zyrtare e RS" Nr. 16/2012).

Përveç që njihen si diploma në tregun e punës, ato njihen gjithashtu për studimet e vazhdueshme në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Serbisë. Ky Urdhër i Qeverisë së Serbisë ka qenë i anuluar nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë si "kundër-kushtetues dhe të paligjshëm" më 30 prill 2014. Qeveria e Serbisë ka nxjerrë një tjetër urdhër (Uredba o posbnom načinu priznavanja unë visokoskolskih dokumenata i vrednovanja studijskih programa univerziteta sa teritorije autonomine e Kosovës dhe Metohisë, duke kryer aktivitetet në pajtim me RKS KB 1244 SB "RS Glasnik RS" Nr. 125/2014).

Zgjidhja e aplikuar nga SPARK nuk ka prodhuar efekte të dëshirueshme, përveç kësaj, marrëveshja për akreditimin e këtyre Diplomave ka hasur edhe në mospërputhjen e programeve të studimit si vështirësi të tilla në procesin e verifikimit në institucionet e arsimit të lartë në Serbi.

Sot Diplomat e verifikimit të arsimit të lartë nga Kosova janë duke kaluar nëpër të procesit të ENIC / NARIC Serbi⁶ - (Qendra për informacion mbi njohjen e arsimit të huaj të lartë dhe të dokumenteve tjera, si dhe njohja për qëllim punësimi) është pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të qendrave të informacionit mbi njohjen dhe njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në vendet tjera. Por, njohja me qëllim të arsimimit të mëtejshëm do të mbetet në kompetencë të institucioneve të pavarura të arsimit të lartë ose universiteteve në bashkëpunim me fakultetet⁷.

Megjithatë, edhe pse kemi mungesë informacioni nga ky institucion ku ka aplikuar një numër të madh i kandidatëve shqiptar për njohjen e diplomës universitare të fituar në universitetet e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Informacioni nga terreni tregon se vetëm disa janë nostrifikuar.

Problemet e identifikuar në procesin e arsimit për komunitetin shqiptar

Sa i përket edukimit të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare, këto probleme mund të identifikohen si kryesore:

- Programe joadekuate që nuk respektojnë nevojën për të ruajtur dhe kultivuar identitetin, kulturën dhe traditën kombëtare shqiptare,

⁶<http://www.mpn.gov.rs/enicnarc-srbija>

⁷<http://www.mpn.gov.rs/enicnarc-srbija>

- Mungesa e teksteve shkollore dhe materialeve për punë,
- Bibliotekat me furnizim të dobët me libra,
- Problemi me statusin e diplomave të lëshuara në Kosovë dhe problemet në njohjen e diplomave të lëshuara në Shqipëri dhe Maqedoni,
- Cilësia e dobët e mësimit të gjuhës serbe për nxënësit që ndjekin mësimet në gjuhën shqipe,
- Mungesa e mësimit të gjuhës shqipe për studentët që ndjekin mësimet e gjuhës serbe,
- Mungesa e mësimit të gjuhës shqipe-serbe dhe zhvillimi i dygjuhësisë (dygjuhësisë) për pedagogët e ardhshëm,
- Institucionet e ndara arsimore dhe arsimit i ndarë.

Përfundim mbi mungesën e teksteve mësimore

Edukim i komunitetit shqiptar në Luginën e Preshevës është i mangët. Komuniteti shqiptar pengohet funksionalisht, që të edukohet në përputhje me normat ligjore në gjuhën e tyre amtare.

Mund të konkludojmë se në aspektin e Kornizës 4A, edukimi i komunitetit shqiptar ka disponueshmërinë, aksesueshmërinë, por problemi çalon edhe në pranueshmërinë e përshtatshmërinë.

Tekstet në gjuhën shqipe vazhdimisht janë "çështje e pazgjidhur", kurrikulat aktuale nuk pasqyrojnë identitetin, kulturën dhe traditën e komunitetit shqiptar .

Diplomat nga Kosova nuk njihen dhe vlefshmëria e diplomave të dhëna në Shqipëri dhe Maqedoni është një sfidë problematike.

Megjithatë, ka shpresë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik ka njoftuar një Memorandum të mundshëm të Mirëkuptimit me shtetet amë për disa pakicat në Serbi, përfshirë edhe komunitetin shqiptar.

Në këtë rast, KKSH-ë ka propozuar tri tema që duhet të adresohen: 1. tekstet për shkollat fillore dhe të mesme, 2. njohjen e diplomave, dhe 3. njohjen e ngritjeve profesionale.

Në kuadër të këtij Memorandumi kemi propozuar që ekspertë nga Ministria e Arsimit në Serbi dhe Shqipëri të eksplorojnë së bashku kurrikulat. Nga kjo do të sqaronim situatën me tekstet shkollore dhe mënyrat e sigurimit të tyre në frymën e procesit të euro-integruese.

Si një masë emergjente, së paku, para çdo procesi tjetër, duhet të sigurojmë një tekst për çdo lëndë për shkollat fillore dhe të mesme. Të përfundojë një proces diskriminues ndaj fëmijëve shqiptarë dhe të vendosim barazi me fëmijët e tjerë në Serbi. E drejta për arsim dinjitoz dhe të standardizuar është një e drejtë elementare e garantuar me Kushtetutë dhe kornizën ligjore.

INFORMIMI

Korniza juridike

E drejta për media në gjuhën shqipe bazohet në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, Konventën kornizë, Kartën, Ligjin për pakicat kombëtare, Ligjin për këshillat e pakicave kombëtare, dhe ligjet të cilat e rregullojnë fushën e mediave.

Kushtetuta e Serbisë e garanton lirinë e shtypit në nenin 50, kurse në nenin 79.1 u garanton pjesëtarëve të pakicave kombëtare të drejtën për informim të plotë me kohë dhe të paanshëm në gjuhën e vet, duke përfshirë të drejtën për shprehjen, marrjen, dërgimin dhe këmbimin e informatave dhe të ideve. Gjithashtu ata kanë të drejtë për themelimin e shërbimeve të veta publike të informimit, në pajtim me ligjin. Konventa kornizë e rregullon çështjen e mediave të pakicave në nenin 9. Sipas këtij neni e drejta e pakicave për media e përfshin lirinë e bindjes dhe të marrjes dhe kumtimin e informatave dhe të ideve në gjuhën e pakicës.

Shteti duhet të aprovojë masat adekuate për të lehtësuar trajtimin e mediave për pjesëtarët e pakicave kombëtare për përparimin e tolerancës dhe mundësimin e pluralizmit kulturor. Karta e rregullon çështjen e mediave në nenin 11. Serbia ka pranuar të aprovojë dispozitat përkatëse, kështu që edhe stacionet radiotelevizive ofrojnë programe në gjuhët rajonale ose të pakicave (neni 11.1 (iii)), të inkurajojë ose lehtësojë emetimin e radio televizioneve dhe të programeve TV

në gjuhët rajonale ose të pakicave rregullisht (neni 11.1 b (ii) dhe c (ii)), të inkurajojë ose lehtësojë prodhimin dhe shpërndarjen e veprave audio dhe audio vizuale në gjuhë rajonale ose të pakicave (neni 11.1 d), të inkurajojë ose të lehtësojë krijimin dhe/ose ruajtjen e së paku një gazete në gjuhën rajonale ose të pakicave (neni 11.1 e (i)), të aplikojë masat ekzistuese të përkrahjes financiare prodhimet audio-vizuale në gjuhët rajonale ose të pakicave (neni 11.1 f (ii) .) Gjithashtu Serbia e ka pranuar nenin 11.2 të Kartës e cila e rregullon çështjen e programeve radiotelevizive nga shtetet fqinje, si edhe nenin 11.3 i cili e rregullon përfaqësimin e interesave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në kuadër të organeve të tilla të cilat mund të vendosen në pajtim me ligjin dhe e garantojnë lirinë dhe pluralizmin e mediave.

Ligji për pakicat kombëtare e garanton të drejtën për informim në gjuhët e pakicave në nenin 17. Kjo normë është njësoj si në normën në Konventën kornizë, ajo e përfshin të drejtën për informim të plotë dhe objektiv, të drejtën për të shprehur, për të marrë, përhapur dhe këmbyer informatat nga ana e mediave të shtypit dhe mediat e tjera (neni 17.1). Në programet e radiove publike dhe të shërbimeve TV shteti i siguron emisionet informative, kulturore dhe arsimore në gjuhët e pakicave. Gjithashtu ai mund të vendosë stacione të veçanta radiotelevizive, që të emitohet programi në gjuhët e pakicave (neni 17.2). E drejta për media e përfshin edhe të drejtën për vendosjen dhe mbajtjen e mediave të veta në gjuhët e pakicave (neni 17.3).

Ligjin për media në nenin 5.1. e parashikon Republika, Krahina autonome, komunat duhet të ofrojnë disa fonde dhe mjete të tjera të nevojshme për punën e shërbimeve publike të pakicave kombëtare dhe të bashkësive etnike. Ligji përmban edhe normat e përgjithshme për ndalimin e diskriminimit dhe gjuhën e urrejtjes të cilat janë të rëndësishme për tolerancën ndëretnike dhe zhvillimin e shoqërisë pluraliste (neni 17 dhe neni 38).

Ligji për Radiodifuzion kryesisht e obligon transmetuesin të prodhojë dhe transmetojë programin në gjuhën serbe ose nëse është në gjuhën e huaj të sigurojë përkthimin në serbisht (neni 72.1). Mirëpo, kjo normë nuk ka të bëjë me mediat e pakicave ose shërbimin publik radiodifuziv kur transmetohet programi në gjuhët e pakicave (neni 72.2). Ligji i rregullon përqindjet e prodhimit të obligueshëm të programit dhe e parashikon që transmetuesit e programeve të pakicave duhet të emitojnë më së paku 50% të programit të prodhimit të vet (neni 73.2). Ligji i rregullon disa obligime të shërbimit publik radiodifuziv që kanë të bëjnë me prodhimin e programeve të destinuara për të gjitha grupet shoqërore, respektimin e standardeve gjuhësore të shumicës dhe të pakicave kombëtare, si edhe programet të cilat e shprehin identitetin kulturor të pakicave kombëtare me mundësinë që të ofrojnë disa programe në gjuhën e pakicave (neni 78.2, 78.3, 78.4).

INFORMIMI NË GJUHËN SHQIPE

Duke marrë parasysh që qëllimet e shtetit në kuptimin e privatizimit të mediave janë përcaktuar me Strategjinë e zhvillimit të sistemit të informimit publik në Republikën e Serbisë deri më 2016, e aprovuar me 2011 si dhe me Ligjin mbi mediat tashmë është përcaktuar privatizimi i mediave lokale dhe jo atyre shtetërore apo krahinore, ndërsa deri më tani nuk kemi veprimet konkrete institucionale që Radio televizioni i Preshevës dhe Bujanocit ti shpëtojnë privatizimit dhe kësisoj të vazhdojnë informimin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, si mundësi për ofrimin e programeve multikulturore.

Duke marrë parasysh rëndësinë e informimit në gjuhën amtare, ka konsideruar që evitimi i privatizimit për këto Radio televizione është i rëndësishëm së veçantë për bashkësinë shqiptare në Serbi. Andaj edhe KKSH ka kërkuar nga organet përgjegjëse sqarimin e statusit juridik të Radio Televizionit Presheva.

Ministria kulturës dhe informimit e Republikës së Serbisë nuk ka krijuar sigurinë juridike për aplikimin e masave mbrojtëse afirmative, në kuptimin e realizimit të drejtës për informim të pjesëtarëve të bashkësisë kombëtare shqiptare, sepse në periudhën prej vitit 2009 deri 2011 çdo vit është ndryshuar mënyra e bashkëfinancimit për ruajtjen e revistës në gjuhën e pakicës kombëtare shqiptare. Me ndërprerjen e plotë të bashkëfinancimit për ruajtjen e një reviste të vetme në gjuhën shqipe në vitin 2012 janë shkëlur parimet kushtetuese dhe ligjore që i garantojnë status dhe mbrojtje juridike të barabartë përfaqësuesve të pakicës kombëtare shqiptare.⁸

Ndërsa, Radio-televizioni i Serbisë emiton program minutësh në gjuhën shqipe pa pëlqimin e KKSH-ës. Këshilli Kombëtar ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të regjistruar Radio Televizionin e Luginës së Preshevës, por është në procedurë e sipër. Ndërkaq, Revista “Nacional” ka botuar numrin festiv në dhjetor të 2019.

Gjithashtu janë planë për të u ndihmuar financiarisht po thuajse të gjitha mediat në gjuhën shqipe si atë radio-vizuale, elektronike dhe të shkruara

PËRDORIMI ZYRTAR I GJUHËS DHE I SHKRIMIT

⁸Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS, nr. 16-2568/11 me datë 18.06.2012.

Korniza juridike

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është një nga të drejtat themelore të cilën e disponojnë pjesëtarët e komunitetit shqiptar. Kjo e drejtë nga aspektet e ndryshme është bërë e drejtë kushtetuese. E drejta për përdorimin e gjuhës së pakicave është edhe standard ndërkombëtar dhe e obligon Republikën e Serbisë në planin ndërkombëtar, për shkak të karakterit obligues të Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejme: Konventa kornizë) dhe Kartës Evropiane për të drejtat rajonale dhe të pakicave (në tekstin e mëtejme: Karta). Gjithashtu kjo e drejtë është rregulluar me ligjet e ndryshme, në mesin e të cilave dy janë vendimtare: Ligji për pakicat kombëtare dhe Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit.

Norma kryesore e Kushtetutës së Republikës së Serbisë në pikëpamje të të drejtave për përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave është shënuar në nenin 79. Sipas nenit 79.1 të Kushtetutës pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë për përdorim të gjuhës dhe të shkrimit të vet; në ato mjedise ku e përbëjnë shumicën e konsiderueshme të popullsisë së pjesëtarëve të pakicave kombëtare, kanë të drejtë që procedura para pushtetit publik (organet shtetërore, organizatat të cilave u janë besuar autorizimet publike, organet e krahinave autonome dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore) gjithashtu të zbatohen në gjuhën e tyre; të përdorin emrin dhe mbiemrin e vet në gjuhën e vet në ato mjedise ku e përbëjnë shumicën e popullsisë, të drejtën që emërtimet lokale tradicionale, emrat e rrugëve, lagjet dhe shenjat topografike të jenë të shkruara edhe në gjuhën e tyre.

Sipas nenit 199.1 secili person ka të drejtë të përdorë gjuhën e vet në procedurën para gjykatës, institucionet tjera të shtetit ose organizatat me autorizime publike, nëse vendoset për të drejtat ose obligimet e tij/e saj. Fakti që personi nuk e di gjuhën e procedurës nuk mund ta pengojnë realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave (neni 199.2). Kushtetuta i garanton të drejtat e përgjithshme gjuhësore në rast të arrestimit (neni 27.2) dhe paraqitjes së denoncimit penal (neni 33.1), por gjithashtu i garanton secilit person të drejtën për përkthyes ligjor falas, nëse ai/ajo nuk flet ose nuk e kupton gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në gjykatë (neni 32.2).

Duke folur për konventat obliguese ndërkombëtare, Konventa kornizë është instrument i rëndësishëm për mbrojtjen e pakicave kombëtare në nivel evropian. Ajo e pranon se gjuha është një nga elementet e domosdoshme të identitetit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare (neni 5.1) dhe përmban norma të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës së identitetit të pakicave kombëtare.

Në pikëpamje të përdorimit të gjuhës së pakicave para pushtetit lokal dhe rajonal, Republika e Serbisë e ka lejuar, për ata të cilët i përdorin gjuhët rajonale ose të pakicave, të paraqesin parashtrësat me shkrim ose me gojë në ato gjuhë; publikimin e dokumenteve të tyre zyrtare të pushtetit rajonal në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicave; publikimin e dokumenteve të tyre

zyrtare relevante në gjuhët rajonale ose të pakicave në përdorim ose, nëse është e domosdoshme lidhur me emrin në gjuhën zyrtare (e), forma tradicionale ose e rregullt e emrave të vendeve në gjuhët rajonale ose të pakicave (neni 10.2 B, C, D). Sa u përket shërbimeve publike të cilat i sigurojnë pushtetet e administratës ose personat të cilët ndikojnë në emrin e tyre, Republika e Serbisë e ka pranuar që t'ua mundësojë përdoruesve të gjuhëve rajonale ose të gjuhës së pakicave që të paraqesin kërkesën në këto gjuhë (neni 10.3 C). Për t'u mundësuar zbatimi i përdorimit zyrtar të gjuhëve rajonale ose gjuhëve të pakicave para organeve të administratës ose shërbimeve publike Republika e Serbisë ka pranuar ta bëjë harmonizimin aq sa ky është i mundur me kërkesat nga shërbimi publik për të punësuarit të cilët kanë njohuri për gjuhët rajonale ose të pakicave që të emërohen në territoret në të cilat kjo gjuhë përdoret (neni 10.4 C). Gjithashtu, Serbia i ka pranuar masat nga neni 10.5 i cili e parasheh që shtetet të obligohen se do të lejojnë përdorimin dhe aprovimin e emrave familjarë në gjuhët rajonale ose të pakicave, me kërkesën e të interesuarve.

Akti kryesor i cili e rregullon përdorimin zyrtar të gjuhës në Republikën e Serbisë është Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit. Ky ligj përgjithësisht e rregullon përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të shkrimit në Republikën e Serbisë dhe në Pjesën e III, veçanërisht e rregullon përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave. Sipas Ligjit përdorimi zyrtar i gjuhëve e nënkupton përdorimin e gjuhës para institucioneve shtetërore, institucioneve krahinore, institucioneve komunale, si edhe institucioneve dhe organizatave me autorizime publike. Kjo sidomos e përfshin: komunikimin oral ose me shkrim në mesin e institucioneve dhe midis tyre dhe të qytetarëve, procedurën për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të qytetarëve dhe obligimet; evidencat, lëshimin e certifikatave publike të cilat janë me interes për zbatimin e të drejtave të qytetarëve, zbatimin e të drejtave, obligimeve dhe detyrave të punëtorëve. Përdorimin e gjuhës në regjistrimin e shenjave topografike, emërtimin e institucioneve, organeve dhe ndërmarrjeve, si edhe publikimin e ftesës publike, informatat dhe paralajmërimet duhet të konsiderohen si përdorim zyrtar i gjuhës.

Kompetencat ligjore të Këshillit kombëtare

Në pikëpamje të përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave kompetencat e Këshillit të pakicave kombëtare janë të rregulluara në nenin 22 të Ligjit për Këshillat e pakicave kombëtare. Këto kompetenca mund t'i klasifikojmë në dy grupe. Në grupin e parë mund të jenë kompetencat të cilat kryesisht kanë të bëjnë me përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave, kompetencat e grupuara në grupin e dytë janë drejtpërsëdrejti të lidhura me çështjen e indikacioneve/shenjave topografike. Këshilli i pakicës kombëtare ka të drejtë të propozojë që gjuha e pakicës të përdoret në përdorim zyrtar në komunë (neni 22.3), të propozojë organin përkatës për mbikëqyrjen e

përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave (neni 22.6), të propozojë organet përkatëse të masave dhe të aktiviteteve lidhur me përkthimin e akteve në gjuhën e pakicës në përdorim zyrtar (neni 22.7), të ndërmarrë masat dhe aktivitetet për përparimin e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave (neni 22.8). Kompetencat e Këshillit të pakicave kombëtare në krahasim me shenjat topografike kanë të bëjnë me të drejtën e përkufizimit të emërtimeve gjeografike tradicionale, nëse gjuha në fjalë është gjuhë e pakicës në përdorim zyrtar në komunë (neni 22.1) dhe e drejta t'i propozojë organit përkatës komunal të bëjë me dije për këta emra (neni 22.2). Këshilli i pakicës kombëtare ka të drejtë të propozojë ndryshimin e emrave të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, etj. (neni 22.4) dhe të deklarohet për çështjen e emërimit të rrugëve, shesheve, lagjeve, etj., nëse gjuha në fjalë është në përdorim zyrtar në komunë (neni 22.5).

PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË AUTORITETET ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti organet republikane nuk kanë filluar përkthimin dhe publikimin e ligjeve më të rëndësishme në gjuhën shqipe. Organet kompetente republikane në frymën e Kartës, duhet të shqyrtojnë publikimin e “Gazetës zyrtare të Republikës së Serbisë” në gjuhën shqipe, para së gjithash atyre ekzemplarëve të cilët përmbajnë materie të rëndësishme legjislative për këtë pakicë.. Në bazë të asaj që theksuam më lart, konsiderojmë që konkretisht në nivel republikan, ku nxirren aktet juridike më të rëndësishme, mungon publikimi i tyre i rregullt në gjuhën shqipe nga ana e organeve kompetente republikane, ndërsa pa përkthimin zyrtar të ligjeve është vështirë të aplikohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj në organet e administratës dhe në gjykata.

Meqë në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës jetojnë numër i konsiderueshëm i qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare dhe në këtë drejtim në kuptimin formalo juridik përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj si gjuhë e barabartë krahas gjuhës serbe dhe shkrimit cirilik është përcaktuar me Statutin e komunës së Bujanocit⁹, Statutin e komunës së Preshevës¹⁰, si dhe me Statutin e komunës së Medvegjës¹¹. Mirëpo, edhe përkundër këtij detyrimi statutar, organet e administratës komunale të komunave të lartpërmendura komunikimin zyrtar me shkrim nuk e bëjnë në gjuhën shqipe me qytetarët e përkatësisë kombëtare shqiptare, përkatësisht aktet administrative individuale të cilat i sjellin një pjese e konsiderueshme e tyre

⁹ “Gazeta zyrtare e rrethit të Pčinjës”, nr. 24/ 2008.

¹⁰ “Gazeta zyrtare e rrethit të Pčinjës”, nr. 26/2008.

¹¹ “Gazeta zyrtare e qytetit të Leskocit”, nr. 18/2008, 38/2012.

nuk janë në gjuhën shqipe. Për të tejkaluar këtë problem, organet shtetërore do duhej të aplikojnë më tepër programe promovuese me qëllim të vetëdijesimit mbi të drejtën e qasjes në gjuhën amtare në organet administrative, por në anën tjetër edhe shtimin e aftësive gjuhësore për të punësuarit në administrata komunale e shtetërore të lartshënuara. Ndërsa, në Medvegjë kjo gjë do të arrihej me hapjen e mjaftueshme të vendeve të punës për përkthyes e cila do të parashihej me Rregulloren mbi sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës në administratën komunale. Konsiderojmë që në këtë mënyrë shërbimi i lartpërmendur do të mundësojë zbatimin e Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve¹² si dhe realizimin e të drejtave tjera të garantuara.¹³

Gjithashtu, edhe pse Kuvendi komunal i Bujanocit ka aprovuar Vendimin mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve në territorin e komunës së Bujanocit,¹⁴ mbishkrimet e institucioneve shtetërore të cilat janë të disperzuara në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës janë të shënuara vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, siç janë Stacionet policore, Enti republikan i gjeodezisë - shërbimi kadastral i paluajtshmërive, Enti republikan për sigurimin shëndetësor, Administrata tatimore e ministrisë së financave, filialet e shërbimit nacional për punësim dhe Fondit republikan për sigurimet pensionale invalidore.

Enti republikan i gjeodezisë, përkatësisht shërbimi kadastral i paluajtshmërive në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, listat poseduese nga baza kadastrale e paluajtshmërive dhe dokumentet tjera të lëshuara i bën vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Ligji mbi mbrojtjen të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare në nenin 11. alineja 4. shprehimisht parashikon që përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare nënkupton dhënien e dokumenteve publike dhe mbajtjen e evidencave zyrtare, si dhe të dhënat personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimin e këtyre dokumenteve në këto gjuhë si të vlefshme.

Vlen të theksohet që në komunën e Medvegjës edhe pse gjuha shqipe me statutin e komunës është parashikuar të jetë në përdorim zyrtar, në shërbimin e administratës së përgjithshme nuk është i punësuar asnjë anëtar i përkatësisë kombëtare shqiptare si ofiqar, që deri diku është parakusht i shënimit të emrit personal në gjuhën shqipe me shkrimin e saj. Gjithsesi, njëra ndër

¹² “Gazeta zyrtare e RS“ nr. 45/91, 53/93, 67/93, 48/94, 101/2005-dhe ligjet tjera, 30/2010.

¹³ **Shembuj:** akte vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik: Aktvendimi i lëshuar nga administrata komunale, nr. 08-465-378 me datë 19.01.2012; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale në Bujanoc, nr. 08-351-35 dt. 27.05.2013; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale në Preshevë, nr. 05.501-04/13 dt. 19.02.2013.; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale në Preshevë, nr. 04.351-56/13 dt. 29.07.2013.

¹⁴ “Gaz. zyrtare e Bujanocit” nr. 10/2014

shkeljet më të rënda të dispozitave ligjore dhe statutare është mospublikimi i vendimeve komunale nga ana e komunës së Medvegjës edhe në gjuhën shqipe me shkrimin e saj.¹⁵

Gjithashtu në stacionet policore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë të gjithë formularët dhe procedurat administrative ndaj palëve të cilat janë pjesëtarë të përkatësisë kombëtare shqiptare udhëhiqen vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nga se në administratën e stacioneve policore nuk ka të punësuar persona të përkatësisë kombëtare shqiptare, sikur që në Rregulloren mbi sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës nuk janë parashikuar vende pune për përkthyes. Kështu që me dispozitën e nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve është rregulluar që formularët e evidencave për nevojën e territorit në të cilin është në përdorim zyrtar gjuha e pakicës kombëtare, të botohen në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicës kombëtare gjuha e së cilës është në përdorim zyrtar. Në këtë kuptim ekziston obligimi i organeve administrative të stacionit policor në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, për t'i lëshuar vendimet dhe vërtetimet në dy gjuhë në bazë të letërnjoftimeve dhe vendbanimeve të dhëna, përkatësisht edhe në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj.

Mbi bazën e kësaj Këshilli ka paraqitur kërkesë te Avokati i popullit i Republikës së Serbisë për fillimin e procedurës ndaj Ministrisë së punëve të brendshme e cila në momentin e paraqitjes së këtij raporti është pushuar.¹⁶

Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit nuk zbatohet në asnjë ndërmarrje publike në komunat e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës si dhe as në qendrat mjekësore në këto komuna, sikur që as raportet mjekësore nuk lëshohen në dy gjuhë. Nga ana tjetër entet republikane dhe shërbimet tjera publike të cilat veprojnë në këto komuna, ndaj palëve të përkatësisë kombëtare shqiptare në asnjë rast nuk kanë aplikuar dygjuhësinë si gjuhë e barabartë në përdorim e parashikuar me ligj.¹⁷

Me hyrjen në fuqi të Ligjeve mbi rregullimin e gjykatave të vitit 2008, aplikimi i të cilëve ka filluar me datë 1 janar 2010, së bashku me Ligjin mbi selitë dhe territoret e gjykatave dhe prokurorive publike të vitit 2008 kanë sjellë probleme serioze në funksionimin dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare me vendbanim në komunat e

¹⁵ Statuti i komunës së Preshevës i publikuar në ("Gazetën zyrtare të qytetit të Leskocit", nr. 18/2008, 38/2012). **Shembuj:** Certifikata e lindjes e lëshuar nga administrata komunale Medvegjë, nr. 200-00-4/2013-31/81278 dt. 16.08.2013.

¹⁶ Numri lëndës tek Avokati i popullit është 16-1813/13; **Shembuj:** Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nr. 27-2609/12-103 me datë 26.12.2012; Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nr. 205-99/11k me datë 05.05.2011; Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, nr. 205-384/12 me datë 20.02.2013; 205-27/13p me datë 30.05.2013; Aktvendimi i dhënë nga ana e SP Bujanoc vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik 205-98/13 me datë 27.05.2013.

¹⁷ Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS, nr. 16-998/12 te 13.07.2012.

Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, para së gjithash për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj në procedurat gjyqësore pranë gjykatës përkatëse. Në gjykatën themelore në Vrajë, në të cilën si njësi themelore janë kyçur gjykatat e deriatëhershme të komunës së Preshevës dhe Bujanocit, janë emëruar 5 gjykatës të përkatësisë kombëtare shqiptare, në raport me numrin e përgjithshëm prej 43 gjyqtarëve të paraparë për Gjykatën themelore, janë vetëm 11,62%. Duke ditur se Gjykata themelore mbulon 7 komuna të rrethit të Pçinjës ku më shumë se 30 % të numrit përgjithshëm të banorëve që jetojnë janë anëtare të pakicës kombëtare shqiptare, në këtë kuptim numri i përmendur i gjyqtarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare është i pamjaftueshëm që të sigurohet aplikimi kualitativ i dygjuhësisë. Deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti, përveç një procedure e cila është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj në Gjykatën themelore në Vrajë- njësi gjyqësore Preshevë, e cila tashmë është mbyllur dhe ka kaluar në Bujanoc, të gjitha procedurat tjera në gjykata janë udhëhequr vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik; po e njëjta situatë mbretëron edhe në prokurori.

Këshilli në pajtim me Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare ka aprovuar propozimin mbi përcaktimin e festave zyrtare për pakicën shqiptare në Republikën e Serbisë. Propozimi në fjalë vite më parë e kemi dërguar në Këshillin republikan për pakica kombëtare i themeluar me Vendimin¹⁸, të cilin e udhëheq kryeministri/e vendit, por ne, si KSSH deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti, ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje dhe rrjedhimisht festat zyrtare për bashkësinë kombëtare shqiptare në Serbi me neglizhimin e Këshillit në fjalë kanë mbetur të pa përcaktuara.

Konsiderojmë që ndërtimi i mekanizmave institucional administrativ me qëllim të përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave, është para se gjithash afirmim i lirisë së shprehjes.

E DREJTA E SHËNIMIT TË EMRIT PERSONAL NË GJUHËN SHQIPE

E drejta në emër personal është e drejtë e njeriut e cila çdo njeriu duhet ti mundësoj realizimin e të drejtës në identitet dhe mbrojtjen e tij.

Shënimi i emrit personal në gjuhën shqipe me shkrimin e saj në librat amëz, është parakusht për realizimin e të drejtës për shënimin e emrit personal në të gjitha dokumentet publike dhe për këtë është e domosdoshme rritja e punës së ministrive kompetente me të punësuarit në shërbimet e ofiqarisë, me qëllim të edukimit dhe trajnimit të tyre lidhur me këtë çështje ashtu që problemet në praktikë të evitohen. Në këtë kuptim, meqenëse ministrinë kompetente nuk kanë ndërmarr

¹⁸ "Gazeta zyrtare e RS", nr. 46/2013

ndonjë veprim konkret, Këshilli kombëtar shqiptar me datë 31 korrik 2014, kishte ndërmarr iniciativën lidhur me organizimin e debatit publik me temën “Si ta shkruajmë emrin personal në gjuhën shqipe me shkrimin e saj në librat amëz dhe dokumentet publike”. Pjesëmarrës ishin zv. Avokati i popullit republikan për pakica kombëtare, ekspertët e albanologjisë, shërbimet e ofiqarisë në komunën e Preshevës, Bujanocit, Medvegjës, Vrajës; stacionet policore në këto komuna.

Debatit i kishte paraprirë kampanja mediale e udhëhequr nga Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare lidhur me të drejtën e shënimit dhe përdorimit të emrit personal në gjuhën shqipe.

Duke pasur parasysh që materniteti për banorët e komunës së Bujanocit gjendet në spitalin e Vrajës, dhe për komunën e Medvegjës gjendet në spitalin e Leskocit, nënat me përkatësi kombëtare shqiptare të cilat janë me vendbanim në këto komuna kryesisht lindin në Vrajë dhe Leskoc. Për këtë arsye regjistrimin e fëmijëve të porsalindur në librat amëz të të lindurve është i obliguar t’ia lajmërojë institucioni shëndetësor në formularin e parashikuar pranë shërbimit të ofiqarisë të administratës komunale të qytetit të Vrajës dhe Leskocit. Megjithatë, pavarësisht faktit se në rendin juridik të Republikës së Serbisë e drejta e pjesëtarëve të bashkësive etnike për përdorimin e emrit personal është ngritur në nivel të të drejtave kushtetuese dhe më përparë është rregulluar me ligj dhe akte tjera nënligjore, zbatimi i kësaj të drejte në praktikë hasë në probleme të mëdha. Kështu, shumë persona kanë ankesa lidhur me punën e përditshme të shërbimit të ofiqarisë në administratat komunale të qytetit të Vrajës dhe të Leskocit ku janë vërejtur probleme në regjistrimin e fëmijëve në librat amëz e që kanë të bëjnë me shkrimin e emrave dhe mbiemrave në gjuhën shqipe dhe shkrimin latin (bastardimi i tyre), siç është paraparë me kushtetutë dhe ligj. Kjo po vjen si pasojë e parimit territorial që ishte në fuqi deri në 2010, lidhur me të drejtën e shënimit të emrit personal për anëtarët e pakicave kombëtare.

Në shërbimet e ofiqarisë të komunës së Preshevës, Bujanocit, Medvegjës, Vrajës, Leskocit dhe komunat tjera në territorin e Republikës së Serbisë, renditja e regjistrimit të emrit personal të anëtarëve të bashkësisë shqiptare në librin amëz të të lindurve me gjuhën dhe shkrimin shqip të cilit i takojnë nuk aplikohet në mënyrë të njëjtë. Në rastet në të cilat emri personal është shkruar në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik procedohet në shumë mënyra ndaj kërkesave për regjistrimin e emrit personal të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare në gjuhën amtare dhe shkrimin e saj – ndonjëherë me propozim për ndryshimin e emrit, e ndonjëherë me kërkesë për përmirësimin e shënimit. Edhe pse Avokati i popullit i Republikës së Serbisë me Rekomandimin e tij nr. 16-166/11 të datës 16.03.2011 i ka rekomanduar Ministrisë për administratë shtetërore dhe vetadministrim lokal të Republikës Serbisë të ndërmarr masat e domosdoshme në kuadër të kompetencave të veta në mënyrë që shërbimet e ofiqarisë t’i zbatojnë drejtë dispozitat ligjore, më

të cilat është përcaktuar mënyra dhe renditja e shënimit paralel të emrit personal të anëtarit të pakicës kombëtare në librin amëz të të lindurve, deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti vazhdon e njëjta praktikë e procedimit në të gjitha administratat komunale, pa përjashtim.¹⁹

Pjesëtarëve të bashkësisë kombëtare shqiptare të cilët janë të lindur në komunat e lartpërmendura u lëshohen certifikatat e lindjes, kurorëzimit, vdekjes dhe vërtetime tjera të cilat janë të shënuara vetëm/edhe në gjuhën serbe dhe shkrim cirilik. Për shembull: në bazë të certifikatës së lindjes dhe certifikatës mbi shtetësinë²⁰ MPB-i emrat dhe mbiemrat ashtu të shkruar të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare i shënon edhe në letërnjoftim. Si pasojës e kësaj, vjen deri te një seri e lëshimeve gjatë shënimit të emrave në gjuhën dhe shkrimin shqip, si dhe shkeljen e të drejtës në identitetin personal të anëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare në Republikën e Serbisë.²¹

E drejta në emrin personal është njëra ndër të drejtat themelore e cila është ngritur në nivelin e garantimit kushtetues të të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta e Serbisë²², në nenin 37, paragrafi 3 proklamon që zgjedhja dhe shfrytëzimi i emrit personal dhe emrave të fëmijëve është zgjedhje e lirë. Për pjesëtarët e pakicave kombëtare Kushtetuta, në nenin 79 paragrafi 1, përmban garancinë shtesë të së drejtës në shfrytëzimin e emrit dhe mbiemrit të tij në gjuhën e amtare.

Megjithatë, KKSH raporton, që anëtarët e bashkësisë kombëtare shqiptare dokumentet personale në gjuhën e tyre i marrin vetëm në komunat ku gjuha shqipe formalisht është e përcaktuar si gjuhë në përdorim zyrtar. Gjithashtu, emrat personal në gjuhën shqipe që përmbajnë shkronja të cilat nuk ekzistojnë në shkrimin cirilikë, po deformohen gjatë procesit të transkriptimit në cirilikë, që hap probleme serioze për identitetin e individit, anëtar i pakicës kombëtare shqiptare.

Prandaj, konsiderojmë që ministritë kompetente duhet të aplikojnë masa edukative për trajtimin e ofiqarëve, si dhe promovimin gjithëpërfshirës mbi të drejtën e shënimit të emrit personal në gjuhën amtare me shkrimin e saj.

Gjithashtu KKSH në bashkëkordinim me OSBE-në ka përfunduar përpilimin e “Katalogut e emrave dhe mbiemra më të shpeshtë në drejtë shkrimin cirilik dhe shqip”

¹⁹ Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS nr. 16-166/11 i datës 16.03.2011; **Shembuj:** Certifikata e lindjes e dhënë në administratën komunale të Vrajës, nr. 200-1-0/2011-3-09 e datës 22.08.2011; Certifikata e lindjes e dhënë nga administrata komunale e Medvegjës, nr. 200-00-4/2013-31/81278 e datës 16.08.2013; Certifikata e lindjes e dhënë nga administrata komunale Savski Venac, numri personal 817, e datës 15.04.2011; Certifikata e lindjes e dhënë nga administrata komunale e Bujanocit, nr. 05-200/573 e datës 04.09.2013; Certifikatën e nënshtetësisë e dhënë nga administrata komunale e Bujanocit, nr. 204-1277/11 e datës 01.07.2011; Aktvendimi i dhënë nga administrata komunale e Bujanoc, nr. 201-124/11 dt. 03.10.2011; Aktvendimi për plotësimin e emrit personal, i dhënë nga administrata e Preshevës, nr. 01.201-35/13 i datës 29.04.2013.

²⁰**Shembuj:** Certifikata e nënshtetësisë e dhënë nga administrata komunale e Bujanocit, nr. 05-204/478 dt.05.09.2013.

²¹ Rekomandimi i Avokatit të popullit i RS, nr. 16-166/11 me datë 16.03.2011.

²² “Gazeta zyrtare e RS”, nr. 98/2006.

SHENJAT TOPOGRAFIKE

KKSH me miratimin e Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare²³, ka marrë përsipër kompetenca të rëndësishme në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip. Në pajtim me këtë ligj, Këshilli kombëtar përcakton emërtimet tradicionale të njësisë të vetëqeverisjes lokale, të vendbanimeve, të toponimeve dhe emërtimeve tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare shqiptare, sepse në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ose vendeve tjera të banuara gjuha shqipe është në përdorim zyrtar; emërtimet të cilat janë të përcaktuara nga Këshilli kombëtar bëhen emërtime në përdorim zyrtar krahas emërtimeve në gjuhën serbe.²⁴ Prandaj, Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare, thekson që rëndësia e promovimit të dygjuhësisë në shenjat treguese është mjet për bartjen e mesazhit që hapësira konkrete është multietnike.

REGJISTRIMI I VITIT 2011

Siç e dini anëtarët e pakicës kombëtare shqiptare, kishin bojkotuar regjistrimin e vitit 2011 të cilët kryesisht jetojnë në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Rreth 80-90% e tyre kishin bojkotuar regjistrimin e popullsisë.

Ne konsiderojmë që organet qendrore shtetërore duhet plotësuar kushtet objektive të cilat do të mundësonin regjistrimin e popullsisë, veçanërisht kthimin e të shpërngulurve shqiptar në vendbanimet e tyre në komunën e Medvegjës, në zonat malore të komunës së Bujanocit dhe Preshevës. Shpërngulja e tyre kishte ndodhur në verën e vitit 1999 pas vendosjes në këto zona të trupave ushtarake dhe policore të Serbisë, të kthyer nga Kosova.

Gjatë regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, në Serbi ishin të regjistruar 61.647 shqiptar, ndërsa me regjistrimin e vitit 2011 janë të regjistruar gjithsej 5.809 Prandaj, shihet qartë që numri aktual prej 5.809 nuk është i saktë.

Ose në komunën e Preshevës 416, Bujanoc 244, Medvegjë 527 në total në tri komunat, gjithsej 1187 shqiptarë dhe 4,622 banorë të pakicës kombëtare shqiptare në pjesën tjetër të Republikës së Serbisë.

²³“Gazeta zyrtare e RS”, nr. 72/2009.

²⁴ Vendimi mbi përcaktimin e emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën dhe shkrimin shqip për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, e publikuar në “Gazetën zyrtare RS”, nr. 118/2012 me datë 15.12.2012.

Megjithatë, gjatë kësaj periudhe organet qendrore të shtetit nuk kanë aplikuar fleksibilitet, veçanërisht në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës gjatë vendosjes dhe realizimit të të drejtave në bazë të numrit që jetojnë në këto komuna. Meqenëse shteti disponon me shumë mekanizma me të cilët do të mblidhte të dhënat e nevojshme mbi numrin e anëtarëve të pakicës shqiptare në Serbi, deri në momentin e paraqitjes së këtij raporti shihet qartë që mungon vullneti institucional për ta realizuar mbledhjen e të dhënave lidhur me numrin e popullsisë. Por, në anën tjetër organet qendrore gjatë sjelljes së vendimeve mbi realizimin e të drejtave kolektive për pakicën shqiptare në Serbi, bazohen në po ato të dhëna.

Por, Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale ka miratuar më 2015 "Raporti i ekipit të ekspertëve të metodologjisë së përdorur për të vlerësuar numrin e banorëve të Serbisë jugore, Regjistrimi 2011" në lidhje me komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Në të njëjtin raport thotë se "Tabela 6. Në popullsi të zakonshme sipas përkatësisë etnike, Serbi të jug: Regjistrimi 2002 (të dhënat e historisë zyrtare) dhe 2011 (e regjistrimit dhe vlerësimit)" në "Regjistrimin e vitit 2011 (të listuar popullsia dhe vlerësimi)", deklaroi në mënyrë të qartë se popullsia nga shqiptarët etnike janë 47,938 banorë për vitin 2011. në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Në mënyrë që të 47,938 vlerësuar nga 4,622 plus për Regjistrimin 2011 të popullsisë sipas përkatësisë etnike shqiptare është 52,560 .

Njashtu, ne duhet të theksojmë se PLANI I VEPRIMIT PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE - I. STATUSI PERSONAL në paragrafin e fundit thotë: Për shkak të bojkotit të regjistrimit në vitin 2011, numri i banorëve në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë nuk ka dhënë një ide realiste gjendja aktuale e popullsisë në këto komuna në jug të Republikës së Serbisë. Me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar ekspertë të pavarur kanë zhvilluar një metodologji në të cilën për të arritur një vlerësim të numrit të banorëve në këto komuna. Vlerësimet e numrit të banorëve në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, të bëra nga ekspertët, me mbështetjen e Institutit Republikan i Statistikave, në çdo gjë, duke respektuar rregullat e Republikës së Serbisë dhe me standardet ndërkombëtare. Rezultatet e vlerësimit do të përdoren në të gjitha fushat d.m.th. procedura në të cilën i buxhetimit është e lidhur me të dhënat statistikore. Kjo metodologji është zhvilluar në mënyrë që të mblidhë të dhëna të plota mbi popullatën me pjesëmarrjen e ekspertëve të pavarur dhe të dhënat e tilla do të përdoren në të ardhmen, duke marrë dialogut konstruktiv me përfaqësues të pakicës kombëtare shqiptare.

Gjithashtu, gjatë gjithë kësaj kohe ka munguar qasja pro aktive e organeve qendrore të shtetit për të vendosur një dialog pro aktiv të besueshëm dhe të drejtpërdrejt me përfaqësuesit politik shqiptar.

PERSONAT E SHPËRNGULUR, PASIVIZIMI

Siç theksuam më lartë, gjatë verës së vitit 1999 ka ndodhur shpërngulja e një numri të konsiderueshëm të bashkësisë shqiptare nga vendbanimet e tyre në komunën e Medvegjës, në zonat malore të komunës së Bujanocit dhe Preshevës. Shpërngulja e tyre kishte ndodhur në verën e vitit 1999 pas vendosjes në këto zona të trupave paramilitare, ushtarake dhe policore të Serbisë, të kthyer nga Kosova.

Një pjesë e tyre kanë ikur në vendet e Evropës perëndimore, ndërsa një shumicë e konsiderueshme jetojnë në Kosovë në kushte jashtëzakonisht të rënda.

Organet qendrore të shtetit këtë spastrim etnik në vazhdimësi e kanë heshtur, dhe nuk kanë bërë as përpjekjen minimale për ti kthyer të shpërngulurit në shtëpitë e tyre. Ndërsa, në kohën e paraqitjes së këtij raporti Ministria e punëve të brendshme e Republikës së Serbisë në mënyre arbitrare po bën pasivizimin e vendbanimeve të tyre duke u thirrur në Ligjin mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin.²⁵ Pasivizimet po bëhen pa ndjekur asnjë procedurë gjyqësore, dhe kështu pa vendim gjyqësor.

Deri në paraqitjen e këtij raporti Stacioni policor i Bujanocit dhe Preshevës, me kërkesën mbi qasjen në informacionet e rëndësishme publike të Këshillit kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare shihet qartë që nga përgjigjet e dhëna nga MUP-i, shihet qartë që vetëm në komunën e Preshevës dhe Bujanocit për vitin 2014 i është pasivizuar 132 qytetarëve e drejta vendbanimit duke u thirrur në Ligjin mbi vendbanimet dhe vendqëndrimet, si dhe 124 pasivizime gjatë vitit 2013. Ndërkaq, veprimet nuk po ndalen. Në vitin 2019 KKSH ka identifikuar që në mënyrë selektive dhe kolektive është realizuar pasivizimi i vendbanimeve dhe shlyerja nga regjistrat civilë të shqiptarëve në komunën e Medvegjës, ka tendencë edhe për komunën e Preshevës dhe Bujanocit me çrast ka njoftuar të gjithë institucionet ndërkombëtare dhe vendore.

KKSH ka konsideruar se shteti me këtë po angazhohet të bëjë ndryshimin artificial të strukturës së popullsisë, derisa e njëjta është e ndaluar me kushtetutën e vendit.

²⁵Ligji mbi vendbanimin dhe vendqëndrimin “Gaz. zyrtare RS”, nr. 87/2012

PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE INSTITUCIONALE

Stacionet policore në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në hierarkinë e tyre komanduese fare pak ka të përfshirë anëtarë të pakicës kombëtare shqiptare, kështu që kemi s'përputhje me pasqyrën etnike të popullsisë.

Kërkesat e gjuhëve të pakicave gjatë procesit të punësimit, sidomos për punët që kërkojnë kontakte më të shpeshta me publikun, nuk aplikohen.

Këshilli kombëtar shqiptar me keqardhje konstaton që anëtarët e pakicës kombëtare shqiptare po mbahen tërësisht larg integritit të tyre në jetën institucionale. Gjendja është e vështirë sidomos në organet qendrore të cilat janë të disperzuara në nivelin lokal, në të cilat punësimi i anëtarëve të pakicës shqiptare është jashtëzakonisht i mangët apo fare i pa pranishëm.

Në anën tjetër shteti, zyrtarisht ende nuk ka aprovuar Strategji mbi integrimin e anëtarëve të pakicave nacionale në jetën publike të vendit. Në kuptimin gjithëpërfshirës nuk po aplikohen programe promovuese që kanë për qëllim integrimin e pakicave nacionale.

P.sh. Në numrin e përgjithshëm të popullsisë në rajonin e Pçinjës, shqiptarët kontribuojnë me 30% të popullsisë, ndërsa nuk ka të punësuar në institucione te këtij niveli.

PJESËMARRJA NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE SISTEMIN GJYQËSOR

Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare, thekson që një numër i konsiderueshëm i dispozitave ligjore vetëm e ka për qëllim të promovojë përfaqësimin adekuat të bashkësive etnike në administratën shtetërore. Megjithatë, kur është fjala për pjesëtarët e bashkësisë kombëtare shqiptare dispozitat e lartshënuara nuk aplikohen nga shteti. Shqiptarët pothuajse tërësisht mbahen larg administratës shtetërore edhe në nivelin lokal ku ata përbëjnë shumicën e popullsisë.²⁶

Paketa e re ligjore për reformën e gjyqësorit e aprovuar në seancën e rregullt të Kuvendit të Republikës së Serbisë më datë 20 nëntor 2013, përfshirë Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi prokurorinë publike, Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi gjykatësit, Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi rregullimin e gjykatave si dhe Ligjin mbi selitë dhe territorin e gjykatave dhe prokurorive publike të cilët në mes të tjerash parashohin edhe rrjetin e gjykatave themelore dhe për kundërvajtje, në komunat në të cilat gjuha shqipe është në përdorim zyrtar: në nenin 2, paragrafi 1, pika 6) nuk parashihet Gjykata për kundërvajtje me seli në Bujanoc, por në vend të kësaj do të jetë njësi gjyqësore në Bujanoc e Gjykatës për kundërvajtje e Vrajës, nga ana tjetër sipas të njëjtit nen dhe paragraf në pikën 30) parashihet që në Preshevë sikur deri më tani të jetë Gjykata për kundërvajtje. Sipas nenit 3, paragrafit 1, pika 10) në Bujanoc do të jetë Gjykata themelore, për territorin e komunës së Bujanocit dhe Preshevës, por këto zgjidhje ligjore nuk parashohin që komuna e Preshevës të ketë Gjykatën themelore me seli në komunën e saj, si parakusht për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj, e njëjta vlen edhe për komunën e Medvegjës për të cilën nuk është paraparë Gjykata themelore. Sipas ligjit të lartpërmendur në nenin 9, paragrafi, 1 pika 14) për territorin e Gjykatës themelore të Bujanocit me njësinë gjyqësore në Preshevë, kompetente është parashikuar të jetë Prokuroria publike themelore me seli në komunën e Vrajës, përkatësisht me njësinë e saj në Bujanoc. Ky strukturim i rrjetëzimit të gjykatave dhe prokurorive e pamundëson realizimin e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj në këtë degë të pushtetit.

Kësisoj Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare shqiptare thekson që “Reforma e sistemit gjyqësor e vitit 2010”, e cila ka sjellë deri te “mbyllja e gjykatave të vogla lokale” dhe janë bartur në “qendrat e mëdha urbane”, gjithashtu ka rritur problemet në qasjen për të drejtën në gjuhët e pakicave kombëtare, veçanërisht në komunat e lartshënuara, në të cilat gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, edhe pse kjo është përcaktuar me Ligjin mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve.²⁷ Në këtë kuptim, KKSH konsideron që reformat e rrjetit të gjykatave nuk kanë marrë fare parasysh pjesëtarët e bashkësisë kombëtare shqiptare, kësaj asnjë gjykatës shqiptar nuk është i pranuar në nivelit e dytë të sistemit gjyqësor në përgjithësi. Gjithashtu, me keqardhje theksojmë faktin që shumica e pjesëtarëve të bashkësisë kombëtare shqiptare nuk i shfrytëzojnë të drejtat e tyre gjuhësore sepse nuk janë të vetëdijshëm për këtë.

Por, shqetësuese mbetet mungesa e programeve promovuese mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, e veçanërisht për të drejtat gjuhësore.

KËRKESAT PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJEVE TË HAPURA NË LUGINËN E PRESHEVËS

²⁷ Neni 11 paragrafi 3 i Ligjit.

Në kohën kur rajoni ka hyrë në fazë të rëndësishme, KSSH ka identifikuar nevojën e ndërmarrjes së veprimeve konkrete dhe të koordinuara për zgjidhjen e çështjeve teknike e që prekin në realitet edhe çështjet jetike të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, në frymën e proceseve integruese që po zhvillohen në Evropë.

Zgjidhja e këtyre çështjeve kërkohet në frymën e këtyre vlerave duke gjetur mbështetje në dokumentet fundamentale që institucionalizojnë mbrojtjen e të drejtave individuale dhe kolektive, siç janë:

- Karta e OKB-së,
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike,
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore,
- Konventa kornizë evropiane për të drejtat e pakicave,
- Konventa evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore,
- Karta evropiane për gjuhët regjionale dhe të pakicave,
- Dokumentet e OSBE-së, prej të cilave veçojmë:
 - Sugjerimet nga Lundi, Oslo dhe Haga,
 - Aktin final të Helsinkit 1975
 - Karta e Parisit për Evropën e re 1990,
 - Dokumentin nga Kopenhaga- Dimensioni njerëzor,
 - Udhëzimet e Lubjanës për integrimin e shoqërive diverse

Zgjidhja e drejtë dhe e qëndrueshme e çështjeve praktike të Luginës së Preshevës nënkupton respektimin e plotë të të drejtave individuale dhe kolektive të shqiptarëve përmes zgjidhjes së drejtë të çështjeve si:

- a) Në përputhje me Deklaratën politike të 14 korrikut 2018 që çështja e Luginës së Preshevës të trajtohet në kuadër të Dialogut Prishtinë-Beograd,
- b) Lugina e Preshevës duhet të ketë formën e organizimit administrativo – territorial kushtetues me funksion në sferat e gjyqësisë, policisë, arsimit, përdorimit të gjuhës dhe simboleve kombëtare, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik, kulturës, planifikimit lokal, planifikimit hapësinor, ambientit ekologjik, resurset natyrore, sferën e banimit, shërbimet sociale.

Të bëhet decentralizimi i pushtetit dhe transferimi i kompetencave prej nivelit qendror në nivelin e vetadministrimit lokal dhe rajonal, institucioneve tjera shtetërore e posaçërisht në sistemin gjyqësor ku duhet krijuar Gjykatat e Kompetencave të Përgjithshme tilla si: Gjykatës Themelore, Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit; Gjykatat e Kompetencave të Veçanta të tilla si Departamenti i Gjykatës Administrative, Gjykata për Kundërvajtje, Gjykata për Kundërvajtje e Apelit dhe Gjykatën Ekonomike.

Prokurorinë Publik: Prokurorinë Themelore Publike, Prokurorinë e Lartë Publike dhe Prokurorinë Publike të Apelit. Gjithashtu, është e nevojshme për të krijuar një mekanizmi gjyqësor që do të mundësonte paraqitjen e mjeteve juridike Gjykatës Supreme Kasacionit dhe gjuhën dhe alfabetin shqiptar.

Çështja e sigurisë publike të jetë në kompetencë ekskluzive të policisë multietnike dhe strukturave të sajë komanduese, hierarkia komanduese të riorganizohet në përputhje me strukturën etnike të popullsisë.

Zhvillimi ekonomik i rajonit përmes krijimit të kushteve lehtësuese të kreditimit të ndërmarrjeve të vogla apo të mesme, tërheqjes së kapitalit të huaj, krijimit të qendrave të biznesit me krijimin e zonës së lirë tregtare, bashkëpunim ndërkufitar në kuadër të projekteve me donatorët ndërkombëtarë.

Privatizimi i ndërmarrjeve ekzistuese shoqërore të bëhet me krijimin e kushteve të barabarta të pjesëmarrjes të të gjitha palëve dhe etnive.

Sistemi arsimor në Luginën e Preshevës (Serbisë) të harmonizohet me sistemin arsimor konform standardeve evropiane për arsim sipas Deklaratës së Bolonjës, në interes të Luginës së Preshevës, plan programet që duhet të përputhen si dhe harmonizimi i plan programeve për fushat e Kulturës, Gjeografisë dhe Historisë. Gjetjen e zgjidhjes së pranueshme për njohjen e Diplomave nga Universitetet e Kosovës dhe Shqipërisë, (sipas Deklaratës së Bolonjës), zgjedhja e aplikuar nga SPARK-u nuk ka prodhuar efektet e dëshirueshme, për më tepër marrëveshja mbi akreditimin e këtyre Diplomave nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë është anuluar si “kundër kushtetuese dhe antiligjore”.

Integrimi proporcional i shqiptarëve në strukturat e pushtetit lokal dhe rajonal dhe të gjitha institucionet shtetërore e publike të të gjitha niveleve.

Aplikimi zyrtar i gjuhës shqipe në institucionet e vetadministrimit lokal, institucionet shtetërore dhe ato publike të të gjitha niveleve, lëshimi I dokumentacioneve personale edhe në gjuhën shqipe (p.sh. pasaporta, letërnjoftimi, patentë shoferi, librezë e shëndetit, certifikata e lindjes, nënshtetësia, pranimi i certifikatave të lindjes dhe kurorëzimit nga Kosova).

Përdorimi zyrtar i simboleve kombëtare të shqiptarëve si dhe e drejta e shënimit publik të datave të rëndësishme nga historia kombëtare dhe emërtimet e rrugëve, shesheve dhe toponimeve gjeografike.

Themelimi i institucioneve për shprehjen, ruajtjen, avancimin e vlerave kulturore, informative, fetare dhe tradicionale, specifike për shqiptarët.

Krijimi i institucioneve të veçanta për mbrojtje sociale të shtresës së rrezikuar të popullatës.

Zhvillimi i institucioneve ekzistuese shëndetësore për mbrojtje primare të popullatës dhe krijimi i mundësisë për mbrojtje sekondare shëndetësore të popullatës së Luginës së Preshevës përmes ndërtimit të spitaleve për këto komuna.

Kthimi i qëndrueshëm i popullatës së zhvendosur përmes kompensimit të dëmeve në pasuritë e tyre, zhvillimit të infrastrukturës rrugore, shëndetësore dhe arsimore.

Të bëhet respektimi i plotë i Ligjit për Amnistinë (Fl.zyrtare e RFJ-se 37/2002 të 03.07.2001) e ish pjesëtarëve të UÇPMB-së dhe ndërprerja e të gjitha proceseve të montuara gjyqësore ndaj shqiptarëve, lirimi i te burgosurve politik.

Ndriçimi i vrasjeve të civilëve gjatë periudhës 1999 – 2001.

Parandalimin e përkeqësimit të situatës politike dhe të sigurisë në Luginën e Preshevës dhe ndërprerjen e aksioneve të xhandarmërisë dhe të policisë speciale si dhe çmilitarizimin e rajonit në suaza të paqes, krijimit të një ambienti të qetë dhe stabile për të gjithë qytetarët e këtij rajoni.

Realizimi i obligimeve të marra nga ana e shtetit me Marrëveshjen për riorganizimit e Trupit koordinues të marsit 2009; Programin qeveritar të vitit 2001 dhe Marrëveshjen e Konçulit të vitit 2001.

Këshilli Kombëtar Shqiptar nënvizon se zgjidhja e drejtë dhe e qëndrueshme e çështjes së Luginës së Preshevës nënkupton respektimin e plotë të të drejtave individuale dhe kolektive të shqiptarëve sipas standardeve më të avancuara rajonale dhe evropiane në suaza të proceseve euro integruese. Pra, në mbështetje të Planit Ahtisaari si të vetmin kompromis që prodhojë paqe, stabilitet rajonal, mbështetur në parimin e reciprocitetit angazhohet për aplikueshmërinë e vlerave dhe garancive të këtij Plani nga sfera e mbrojtjes së komuniteteve edhe në Luginë të Preshevës.

INSTITUCIONI I KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR

Konsiderojmë që Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë që shpalli antikushtetuese disa dispozita ligjore të Ligjit mbi këshillat kombëtare të pakicave nacionale shfuqizoi mu ato dispozita që garantonin të drejtat kolektive të pakicave kombëtare të cilat Këshilli Kombëtar Shqiptar në vitet e fundit i ka ushtruar dhe përdorur ligjërisht. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese hodhi poshtë një nivel ekzistues kushtetues të të drejtave të pakicave me ç ‘rast shuhen edhe ato pak të drejta të fituara kolektive të shqiptarëve në Serbi si dhe u përligjin me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi këshillat kombëtare të pakicave nacionale në vitin 2018..

Kërkojmë kthimin në fuqi të Ligjit mbi këshillat kombëtare të pakicave nacionale të amadamentohet konform Konventës kornizë evropiane për të drejtat e pakicave dhe në harmoni me Planin e Ahtisaarit.

Ngritjen e nivelit buxhetor të Këshilli Kombëtar Shqiptar në raport me numrin e popullsisë dhe nevojat e domosdoshme për të funksionuar si institucion kompetent për arsimin, kulturën, informimin, përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip.

KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR

Nr

Data :

Bujanoc

K R Y E T A R

Ragmi Mustafa